



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr.44

29 prill

2012

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Dekret nr. 7349 datë 28.3.2012	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	2335
Dekret nr. 7355 datë 2.4.2012	Për lejimin e lënies të shtetësisë shqiptare.....	2335
Vendim i KM nr. 206, datë 21.3.2012	Për një ndryshim në vendim nr. 98, datë 9.2.2011 të Këshillit të Ministrave “Për strukturën e Komisionit Shtetëror për Ndihmën Juridike dhe organikën e Sekretariatit të tij”.....	2336
Vendim i KM nr. 207, datë 21.3.2012	Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të komunës Gjergjan, të qarkut të Elbasanit.....	2338
Vendim i KM nr. 208, datë 13.3.2012	Për kalimin e pronës “Muzeu Historik Kombëtar” në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve	2339
Vendim i KM nr. 209, datë 26.1.2012	Për procedurën e dhënies së autorizimit për magazinimin, transferimin dhe asgjësimin e lëndëve plasëse, për përdorim civil.....	2339
Vendim i KM nr. 212, datë 30.3.2012	Për miratimin e kriterëve për ngritjen e njërive të auditimit të brendshëm në sektorin publik.....	2342
Vendim i KM nr. 215, datë 28.3.2012	Për disa shtesa në vendimin nr. 642, datë 11.10.2005 të Këshillit të Ministrave “Për këshillat mbikëqyrës të shoqërive anonime shtetërore”.....	2343
Vendim i KM nr. 216, datë 28.3.2012	Për kompensimin e vlerës së taksës së biznesit të vogël, të përdorur për rimbursimin e pajisjeve fiskale dhe taksimetrave, për 5 bashki dhe 13 komuna.....	2344
Vendim i KM nr. 217, datë 28.3.2012	Për një ndryshim në vendimin nr. 755, datë 15.9.2010 të Këshillit të Ministrave “Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i linjës së tensionit të lartë 400 kv Tiranë – Podgoricë, qarku Lezhë”..	2345

Vendim i KM nr. 219, datë 28.3.2012	Për një ndryshim në vendimin nr. 553, datë 12.8.2004 të Këshillit të Ministrave “Për procedurat dhe kushtet për dhënien e lejeve të koncesionit për ndërtimin dhe përdorimin e rafinerive, të naftës-jellësve e gazsjellësve”, të ndryshuar.....	2345
Vendim i KM nr. 221, datë 28.3.2012	Për miratimin e rregullave teknike “Për etiketimin e produkteve të qelqit kristal”.....	2346
Vendim i KM nr. 222, datë 28.3.2012	Për miratimin e rregullave teknike për etiketimin e materialeve që përdoren në përbërësit kryesorë të veshjeve të këmbës, në shitje për konsumatorët.....	2351
Vendim i KM nr. 223, datë 28.3.2012	Për një ndryshim në vendimin nr. 23, datë 11.1.2012 “Për kuotat e pranimit dhe tarifat e shkollimit për ciklin e dytë të studimeve “Master profesional”, me kohë të pjesshme dhe edukimin në distancë, në institucionet publike të arsimit të lartë, në vitin akademik 2011-2012”.....	2355
Vendim i KM nr. 224, datë 28.3.2012	Për një shtesë në vendimin nr. 473, datë 16.7.2004 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në komunën e Ishmit” dhe për një shtesë në vendimin nr. 284, datë 12.3.2008 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës përfundimtare të pyjeve dhe kullotave që do të transferohen në pronësi të njësisë së qeverisjes vendore, komuna Ishëm, të qarkut të Durrësit”.....	2356
Vendim i KM nr. 226, datë 9.4.2012	Për rishpërndarje në numrin e punonjësve dhe të fondeve buxhetore, miratuar për vitin 2012, nga Shërbimi Informativ i Shtetit të Ministria e Mbrojtjes.....	2357
Urdhër i MASH nr. 16, datë 17.1.2012	Për riorganizimin e Fakultetit të Mësuesisë në Fakultetin e Edukimit dhe Filologjisë dhe në Fakultetin e Shkencave Natyrore dhe Shkencave Humane në universitetin “Fan.S.Noli” Korçë.....	2357
Urdhër i MASH nr.92, datë 15.3.2012	Për riorganizimin strukturor nga “Fakulteti i Drejtësisë” dhe “Fakulteti i Shkencave Sociale” të shkollës së lartë universitare private “Universiteti Kristal”, në një fakultet të vetëm “Fakulteti i Drejtësisë dhe Shkencave Sociale”.....	2359
Urdhër i MASH nr. 102, datë 21.3.2012	Për hapjen e programit të studimit të ciklit të parë <i>bachelor</i> në “Psikologji”, programit të studimit të ciklit të dytë master i shkencave në “Arkitekturë”, të institucionit të arsimit të lartë privat “Universiteti Amerikan i Tiranës”.....	2360
Urdhër i MASH nr. 124, datë 29.3.2012	Për akreditim ininstitucional dhe programeve të studimit “Bachelor” në “Ekonomi”, “Marrëdhënie ndërkombëtare/diplomaci”, “Shkenca politike-administratë publike” të institucionit “Shkolla e Lartë Private Mesdhetare e Shqipërisë”.....	2360
Vendim i GJK nr. 20, datë 13.4.2012	Me objekt shfuqizimin, si të papajtueshëm me Kushtetutën, të vendimit nr. 00-2009-303 (95), datë 19.3.2009 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.....	2361
Vendim i GJK nr. 21, datë 16.4.2012	Me objekt shfuqizimin, si të papajtueshëm me Kushtetutën, të vendimit nr.64, datë 1.10.2006 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Librazhd; të vendimit nr. 267, datë 19.6.2007 të Gjykatës së Apelit Durrës, dhe vendimit nr. 211 datë 9.4.2009 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë (Dhoma e Këshillimit).....	2366

DEKRET
Nr. 7349, datë 28.3.2012

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92 pika “c” dhe 93 të Kushtetutës, si dhe nenit 9, 10 dhe 20 të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998 “Për shtetësinë shqiptare”, të ndryshuar, bazuar edhe në propozimin e Ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

U jepet shtetësia shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:

1. Hajris Nefail Rakipi
2. Urim Alil Murati
3. Andina Urim Murati
4. Halil Urim Murati
5. Hüseyin Yusuf Yilmaz
6. Lulzim Isa Tahiri
7. Mefail Avdulla Thaqi
8. Ismail Fevzullah Abakay
9. Stela Vladimir Koçi (Ursachii)
10. Sherin Yuossef Iskander Kamel
11. Nikoll Matosh Markaj
12. Aydin Mustafa Ūremez
13. Lavdim Tafil Çitaku
14. Hasan Fatih Durmuş Sürücü
15. Ömer Süleyman Akin
16. Orhan Abdurrahman Hastürk
17. Andi Vehip Bakiri
18. Enrico Sergio Giovannini

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Bamir Topi

DEKRET
Nr. 7355, datë 2.4.2012

PËR LEJIMIN E LËNIES TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92 pika “c” dhe nenit 93 të Kushtetutës, si dhe të neneve 15 dhe 20 të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998 “Për shtetësinë shqiptare”, të ndryshuar, bazuar edhe në propozimin e Ministrit të Brendshëm,



DEKRETOJ:

Neni 1

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:

1. Ermal Tefik Spaho
2. Marin Fatmir Murataj
3. Alma Polikron Preston (Kosta)
4. Ilda Ilir Gkaravounis (Loka)
5. Mustafa Ferit Fezga
6. Drita Sejdo Fezga (Hasimi)
7. Elton Zalo Sheme
8. Hasan Emin Emini
9. Sokol Hysni Saliaj
10. Mirela Xhemil Mataj

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Bamir Topi

VENDIM

Nr. 206, datë 21.3.2012

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 98, DATË 9.2.2011 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR STRUKTURËN E KOMISIONIT SHTETËROR PËR NDIHMËN
JURIDIKE DHE ORGANIKËN E SEKRETARIATIT TË TIJ”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 7 të nenit 6 të ligjit nr. 10 039, datë 22.12.2008 “Për ndihmën juridike”, me propozimin e Ministrisë të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:


Lidhja nr. 2 “Organika e Sekretariatit të Komisionit Shtetëror për ndihmën juridike”, bashkëlidhur vendimit nr. 98, datë 9.2.2011 të Këshillit të Ministrave, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Skema nr.1

STRUKTURA E KOMISIONIT SHTETËROR TË NDIHMËS JURIDIKE





Lidhja nr.2

ORGANIKA E SEKRETARIATIT TË KOMISIONIT SHTETËROR PËR NDIHMËN JURIDIKE

POZICIONI	KATEGORIZIMI	NUMRI
SPECIALIST ARKIV PROTOKOLL/SEKRETAR	IV-a	1
SPECIALIST JURIST	IV-a	1
SPECIALIST SHËRBIMI DHE KONTROLLI	IV-a	1
SPECIALIST EKONOMIST	IV-a	1
PUNONJËS GJITHSEJ		4

VENDIM

Nr. 207, datë 21.3.2012

PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË KOMUNËS GJERGJAN, TË QARKUT TË ELBASANIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të komunës Gjergjan, të qarkut të Elbasanit, sipas lidhjes nr.1 që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Lista paraprake, sipas kërkesave të këshillit të kësaj komune, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të komunës Gjergjan të qarkut të Elbasanit, miratuar me vendimin nr. 1328, datë 1.10.2008 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në komunën Gjergjan, të qarkut të Elbasanit”.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe komuna Gjergjan për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Sali Berisha

Gjergjan, Elbasan

Lidhja nr. 1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
1-8	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore	Në pronësi
9-12	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e shëndetit publik	Në pronësi
13-87	Prona që përdoren për infrastrukturë dhe shërbime publike (troje dhe sheshe)	Në përdorim
88-102	Prona që përdoren për shërbime funerale	Në pronësi
103-653	Infrastrukturë (rrugë vendore)	Në pronësi
697,698,699,700,701,703,704,705,706,707,710,711,712,713,716,717,718,719,721,722,723,724,725,728,729,732,733	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive)	Në përdorim
702,708,709,714,715,720,726,727,730,731,734	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka joproduktive dhe kanale të treta)	Në pronësi

VENDIM
Nr. 208, datë 13.3.2012

**PËR KALIMIN E PRONËS “MUZEU HISTORIK KOMBËTAR” NË PËRGJEGJËSI
ADMINISTRIMI TË MINISTRISË SË TURIZMIT, KULTURËS, RINISË DHE SPORTEVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 8, pika 3 e 13 të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin e pronës “Muzeu Historik Kombëtar”, me numër pasurie 0-11, në zonën kadastrale nr. 8350, Tiranë, në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, sipas formularit që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Ngarkohen Ministri i Brendshëm, Ministri i Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve dhe Kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 209, datë 26.1.2012

**PËR PROCEDURËN E DHËNIES SË AUTORIZIMIT PËR MAGAZINIMIN,
TRANSFERIMIN DHE ASGJËSIMIN E LËNDËVE PLASËSE, PËR PËRDORIM CIVIL**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 1 të nenit 9 të ligjit nr. 9126, datë 29.7.2003 “Për përdorimin civil të lëndëve plasëse në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Autorizimin për magazinimin, transferimin dhe asgjësimin e lëndëve plasëse për përdorim civil, për personat fizikë ose juridikë, privatë apo publikë, vendas ose të huaj, jepet nga komisarati i policisë së rrethit, ku subjekti zhvillon aktivitetin me lëndë plasëse.
2. Personi fizik ose juridik, që kërkon të pajiset me autorizim për magazinimin, transferimin dhe asgjësimin e lëndëve plasëse për përdorim civil, duhet të plotësojë këto kritere:
 - a) Të jetë i specializuar në veprimtarinë e lëndëve plasëse;
 - b) Të mos jetë në ndjekje penale ose në proces gjyqësor penal;
 - c) Të ketë zotësi të plotë mendore dhe fizike për të vepruar;
 - ç) Të ketë vendbanimin ose selinë në territorin e Republikës së Shqipërisë;
 - d) Të mos jetë i dënuar me vendim gjykatë të formës së prerë për një çështje penale.
3. Verifikimi i kritereve të lartpërmendura bëhet nga komisaritet e policisë së rrethit ku subjekti zhvillon aktivitetin me lëndë plasëse, në përputhje me legjislacionin në fuqi për fushat përkatëse sipas këtij dokumentacioni:
 - a) Fotokopjes së noterizuar të diplomës së drejtuesit teknik dhe të kontratës së tij me subjektin;
 - b) Fotokopjes së noterizuar të dëshmisë së zjarrmëtarit;
 - c) Vërtetimeve të prokurorisë dhe gjykatës;



- ç) Raportit mjekësor ku të vërtetohet gjendja fizike dhe psikike;
 - d) Ekstraktit të regjistrimit tregtar dhe atij historik për të dhënat e subjektit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
 - dh) Dëshmisë së penaltetit.
4. Subjekti i interesuar, që kërkon të pajiset me autorizim për miratimin e depos/depove të magazinimit të lëndëve dhe materialeve plasëse për përdorim civil, dorëzon në komisariatit e policisë së rrethit, ku është ndërtuar depoja/depot, këto dokumente:
- a) kërkesën me shkrim, duke përcaktuar vendndodhjen e objektit, llojin, kapacitetin mbajtës për lëndë plasëse, kapsolla e fitila, të depos dhe afatin e përdorimit të saj;
 - b) dokumentin e identifikimit të personit fizik ose të përfaqësuesit ligjor të subjektit;
 - c) pëlqimin nga bashkia ose komuna që ka në juridiksion depon/t, në të cilën do të magazinohen dhe ruhen lëndët plasëse për përdorim civil;
 - ç) fotokopjen e noterizuar të lejes së ndërtimit të depos/depove, ku përcaktohet “objekt sipërfaqësor për magazinimin e lëndëve plasëse për përdorim civil me koordinata: x,y,z”;
 - d) aktkolaudimin e objektit, të nënshkruar nga specialist inxhinier miniere, që përcakton se objekti i ndërtuar i plotëson kushtet për magazinimin e lëndëve plasëse për përdorim civil, në përputhje me rregulloren e teknikës së sigurimit të lëndëve plasëse për përdorim civil në Republikën e Shqipërisë;
 - dh) projektin teknik të hartuar nga institucionet projektuese përkatëse, të miratuar në repartin e inspektim-shpëtim-minierave, (RISHM) edhe në rastet kur objekti është i adoptuar, që përcakton se objekti i plotëson kushtet për magazinimin e lëndëve plasëse për përdorim civil, në përputhje me rregulloren e teknikës së sigurimit për përdorimin civil të lëndëve plasëse në Republikën e Shqipërisë, si dhe aktin e pronësisë së objektit ose kontratën e qirasë;
 - e) kontratën e lidhur me Shërbimin e Ruajtjes dhe Sigurisë Fizike, për ruajtjen e depos/depove të lëndëve plasëse, ku të pasqyrohet numri i vendrojave së bashku me kohën (orarin) e shërbimit.
5. Shqyrtimi i dokumentacionit për miratimin e depos/depove për magazinimin e lëndëve plasëse për përdorim civil dhe kthimi i përgjigjes bëhet nga komisariati i policisë, brenda 25 (njëzet e pesë) ditëve nga data e aplikimit për marrjen e tij.
6. Autorizimi për magazinimin e lëndëve plasëse përcakton specifikisht kapacitetin mbajtës për lëndë plasëse, kapsollë dhe fitila.
7. Subjekti i interesuar, që kërkon të pajiset me autorizim për transferimin e lëndëve dhe materialeve plasëse për përdorim civil, depoziton në komisariatit e policisë së rrethit, ku ndodhet depoja/t e miratuara, këto dokumente:
- a) kërkesën me shkrim për transferimin e lëndëve dhe materialeve plasëse për përdorim civil (7 ditë para, kur transferimi do të bëhet brenda vendit dhe 10 ditë, përpara ditës së mbërritjes në pikat e kalimit kufitar, kur vijnë nga jashtë vendit), në të cilën të përcaktohen: emri i zjarrmëtarit, drejtuesit të automjetit, tipi dhe targa e automjetit, sasia e ndarë për lëndë plasëse, kapsolla dhe fitila që do të transferohen, vendi i tërheqjes, subjekti furnizues dhe subjekti përdorues, adresa e depos ku do të magazinohet, itinerari i lëvizjes dhe data e transferimit;
 - b) fotokopjen e noterizuar të autorizimit për përdorim civil të lëndëve plasëse, lëshuar nga Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës;
 - c) fotokopjen e autorizimit të miratimit të depos/depove për magazinimin e lëndëve dhe materialeve plasëse për përdorim civil, miratuar nga komisariati i policisë, në të cilën do të magazinohet lënda/materialet plasëse për përdorim civil;
 - ç) kontratën me një subjekt tjetër, të miratuar nga komisariati i policisë, për magazinimin e lëndëve dhe materialeve plasëse, kur subjekti nuk disponon depo;
 - d) fotokopjen e lejes së drejtimit të drejtuesit të automjetit, sipas kritereve të përcaktuara në

rregulloren e teknikës së sigurimit për përdorimin civil të lëndëve plasëse në Republikën e Shqipërisë;

dh) kontratën me Shërbimin e Ruajtjes dhe Sigurisë Fizike dhe fotokopjen e lejes së armës së zjarrit të punonjësit që do të kryejë shoqërimin, gjatë transferimit të lëndëve plasëse për përdorim civil;

e) aktkolaudimin teknik të posaçëm për automjetin e transportit, sipas kritereve të përcaktuara në rregulloren e teknikës së sigurimit për përdorimin civil të lëndëve plasëse në Republikën e Shqipërisë.

8. Shqyrtimi i dokumentacionit për transferimin e lëndëve plasëse për përdorim civil dhe kthimi i përgjigjes bëhet nga komisariati i policisë brenda 7 (shtatë) ditëve, kur transferimi kryhet brenda vendit dhe 10 (dhjetë) ditëve, kur lëndët plasëse vijnë nga jashtë vendit.

9. Subjektet që kërkojnë paraprakisht të pajisen me autorizim për transferimin e lëndëve plasëse për përdorim civil, me qëllim pajisjen nga Ministria e Mbrojtjes me licencë për import, eksport dhe prodhim të lëndëve plasëse për përdorim civil, duhet të paraqesin këto dokumente në komisariatit e policisë;

a) kërkesën me shkrim, në të cilën të përcaktohen tipi dhe targa e automjetit, si dhe kapaciteti mbajtës i lëndës plasëse, kapsolla dhe fitila;

b) fotokopjen e lejes së drejtimit të drejtuesit të automjetit, sipas kritereve të përcaktuara në rregulloren e teknikës së sigurimit për përdorimin civil të lëndëve plasëse në Republikën e Shqipërisë;

c) aktkolaudimin teknik të posaçëm për automjetin e transportit, sipas kritereve të përcaktuara në rregulloren e teknikës së sigurimit për përdorimin civil të lëndëve plasëse në Republikën e Shqipërisë.

10. Shqyrtimi i dokumentacionit për pajisjen me autorizim për transferimin e lëndëve plasëse për përdorim civil, sipas pikës 9 të këtij vendimi, bëhet nga komisariati i policisë brenda 25 (njëzet e pesë) ditëve nga data e aplikimit për marrjen e tij.

11. Subjekti i interesuar, që kërkon të pajiset me autorizim për asgjësimin e lëndëve dhe materialeve plasëse për përdorim civil të skaduara, si dhe mbeturinave të tyre, depoziton në komisariatit e policisë së rrethit, ku do të kryhet asgjësimi, këto dokumente:

a) kërkesën, në të cilën përcaktohen vendi, koha, mënyra e asgjësimit, sasia e ndarë për lëndë plasëse, kapsolla dhe fitila, drejtuesi teknik dhe emrat e stafit teknik që do të merret me asgjësimin e këtyre lëndëve, të shoqëruara me dëshmitë përkatëse;

b) autorizimin për përdorimin civil të lëndëve plasëse, nga Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës;

c) aktin e vlerësimit për sigurimin teknik, ku të përcaktohet se asgjësimi i lëndëve plasëse nuk rrezikon apo dëmton jetën e njerëzve, kafshëve dhe vlerave materiale përreth, të firmosur nga specialistët përkatës;

e) autorizimin nga agjencia rajonale për mbrojtjen e mjedisit;

d) autorizimin nga Policia e Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit;

dh) autorizimin nga bashkia ose komuna që ka në juridiksion vendin ku do të asgjësohen lëndët plasëse.

12. Në vendin ku do të kryhet asgjësimi i lëndëve plasëse, për përdorim civil, të skaduara, si dhe të mbeturinave të tyre, në varësi të mënyrës së asgjësimit, subjekti merr masa të plota për sigurimin teknik të mjedisit përreth, me qëllim parandalimin e ngjarjeve aksidentale, që mund të shkaktohen nga vala goditëse e shpërthimit apo nga zjarri, me pasoja për jetën e njerëzve, kafshëve dhe vlerave materiale.

13. Shqyrtimi i dokumentacionit për asgjësimin e lëndëve dhe materialeve plasëse të përdorimit civil të skaduara, si dhe të mbeturinave të tyre dhe kthimi i përgjigjes bëhen nga komisariati i policisë brenda 10 (dhjetë) ditëve nga data e aplikimit për marrjen e tij.



14. Policia e Shtetit, për qëllimet e përcaktuara në këtë vendim, ka të drejtë të kryejë kontrole dhe verifikime, rast pas rasti, në depot e magazinimit, gjatë transferimit dhe asgjësimit të lëndëve plasëse për përdorim civil.

15. Autorizimi për magazinimin, transferimin dhe asgjësimin e lëndëve plasëse për përdorim civil hiqet nga Policia e Shtetit, në rastet:

a) kur subjekti, gjatë magazinimit, transferimit dhe asgjësimit shkel rregullat e sigurisë teknike, të parashikuara në rregulloren e teknikës së sigurimit për përdorim civil të lëndëve plasëse në Republikën e Shqipërisë dhe kriteret e përcaktuara në këtë vendim, duke rrezikuar jetën e njerëzve, kafshëve dhe vlerave materiale;

b) kur subjekti kryen veprë penale që lidhet me ushtrimin e veprimtarisë së magazinimit, transferimit dhe asgjësimit.

16. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 212, datë 30.3.2012

**PËR MIRATIMIN E KRITEREVE PËR NGRITJEN E NJËSIVE TË AUDITIMIT TË
BRENDSHËM NË SEKTORIN PUBLIK**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 17 të ligjit nr. 9720, datë 23.4.2007 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Veprimtaria e auditimit të brendshëm të kryhet në të gjitha njësitë e sektorit, e organizuar, si më poshtë:

a) Në njësitë qendrore të njësive të qeverisjes së përgjithshme, shoqëritë tregtare me mbi 50% kapital publik, autoritetet e përbashkëta, të cilat zotërohen, kontrollohen, financohen ose u garantohet financimi nga një njësi e qeverisjes së përgjithshme, të ngrihen njësi të auditimit të brendshëm, me përjashtim të rasteve kur nuk kanë njësi shpenzuese të vartësisë;

b) në njësitë shpenzuese në vartësi të njësisë qendrore, që kanë njësi vartëse shpenzuese, të ngrihen njësi të auditimit të brendshëm me përjashtim të rasteve kur kanë më pak se tre njësi shpenzuese të vartësisë.

c) të gjitha njësitë shpenzuese, ku nuk ngrihet njësi e auditimit të brendshëm, do të auditohen nga njësitë audituese të organit epror;

ç) të gjitha njësitë shpenzuese, ku nuk ngrihet njësi e auditimit të brendshëm dhe nuk kanë vartësi nga ndonjë organ epror, do ta sigurojnë shërbimin e auditimit të brendshëm nëpërmjet marrëveshjeve me njësitë shpenzuese që kanë njësi auditimi të brendshëm apo nëpërmjet shërbimit të kontraktimit, sipas pikave 2 dhe 3 të nenit 17 të ligjit nr. 9720, datë 23.4.2007 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, të ndryshuar.

2. Njësia e auditimit të brendshëm detyrimisht duhet të përbëhet nga minimumi, tre auditues, përfshirë drejtuesin e njësisë.

3. Njësia e auditimit të brendshëm të njësive shpenzuese të vartësisë, përveç sa parashkohet në ligjin nr. 9720, datë 23.4.2007, raportin periodik ia dërgon edhe titullarit të njësisë publike.

4. Titullari i njësisë publike është përgjegjës për ngritjen, funksionimin, garantimin e kapaciteteve dhe garantimin e pavarësisë funksionale dhe organizative të njësive të auditimit të brendshëm brenda njësisë publike.

5. Titullari i njësisë publike ka të drejtë në çdo kohë të kërkojë kryerjen e shërbimit të auditimit në çdo njësi shpenzuese të njësisë publike.

6. Zbatimi i pikës 3 të ligjit nr. 9720, datë 23.4.2007, do të kryhet vetëm pasi të jenë ezauruar mundësitë e zbatimit të pikës 2 të ligjit të sipërpërmendur.

7. Ngarkohen Ministri i Financave dhe titullarët e njësive publike për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 215, datë 28.3.2012

PËR DISA SHITESA NË VENDIMIN NR. 642, DATË 11.10.2005 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR KËSHILLAT MBIKËQYRËS TË SHOQËRIVE ANONIME
SHTETËRORE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 8 e 18 të ligjit nr. 7926, datë 20.4.1995 “Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare”, të ndryshuar, dhe të neneve 124 e 128 të ligjit nr. 8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 642, datë 11.10.2005 të Këshillit të Ministrave, bëhen këto shtesa:

1. Në titullin e vendimit, pas fjalëve “...shoqërive anonime shtetërore...”, shtohen fjalët “... dhe bordet apo komisionet e ndryshme të njësive të qeverisjes qendrore...”.

2. Pas pikës 3 të vendimit, shtohet një paragraf, me këtë përmbajtje:

“ Funksionarëve politikë, nëpunësve civilë dhe punonjësve të administratës shtetërore u ndalohet pjesëmarrja, me të drejtë pagese, në më shumë se 2 (dy) borde apo komisione të ndryshme të njësive të qeverisjes qendrore.”.

3. Ngarkohen të gjitha njësitë e qeverisjes qendrore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha



VENDIM
Nr. 216, datë 28.3.2012

**PËR KOMPENSIMIN E VLERËS SË TAKSËS SË BIZNESIT TË VOGËL, TË PËRDORUR
PËR RIMBURSIMIN E PAJISJEVE FISKALE DHE TAKSIMETRAVE, PËR 5 BASHKI
DHE 13 KOMUNA**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13 e 15 të ligjit nr. 10 487, datë 5.12.2011 “Për buxhetin e vitit 2012”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kompensimin e vlerës së taksës së biznesit të vogël, të përdorur për rimbursimin e vlerës së pajisjeve fiskale dhe taksimetrave, për njësitë e qeverisjes vendore, për 5 bashki dhe 13 komuna, sipas lidhjes nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Ky fond, në vlerën 15 777 775 (pesëmbëdhjetë milionë e shtatëqind e shtatëdhjetë e shtatë mijë e shtatëqind e shtatëdhjetë e pesë) lekë, përballohet nga fondi i kontigjencës, i miratuar në buxhetin e vitit 2012.

3. Ngarkohen Ministria e Financave dhe njësitë e qeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Lidhja nr. 1

Nr.	Emri i NJQV-së	Vlera (në lekë)
1	Bashkia Belsh	510,258
2	Bashkia Librazhd	1,728,723
3	Bashkia Krujë	2,816,500
4	Bashkia Përrenjas	911,455
5	Bashkia Pogradec	3,939,509
6	Komuna Kutalli	256,250
7	Komuna Labinot-Fushë	743,741
8	Komuna Gorë (Korçë)	13,000
9	Komuna Roshnik	24,375
10	Komuna Q. Bulgarec	411,725
11	Komuna Qukës	271,820
12	Komuna Golem (Kavajë)	1,640,890
13	Komuna Kozarë	383,125
14	Komuna Mollaj (Korçë)	218,700
15	Komuna Rajcë	348,506
16	Komuna Velabisht	442,728
17	Komuna Ana e Malit	187,670
18	Komuna Golem (Lushnjë)	928,800
	Shuma	15,777,775

VENDIM
Nr. 217, datë 28.3.2012

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 755, DATË 15.9.2010 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË
PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I
LINJËS SË TENSIONIT TË LARTË 400 KV TIRANË – PODGORICË, QARKU LEZHË”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21 të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në tabelën e të shpronësuarve, bashkëlidhur vendimit nr. 755, datë 15.9.2010 të Këshillit të Ministrave, pronari “Prend Ndue Ndreca” zëvendësohet me “Zef Ndue Ndreca” dhe shoqërohet me të dhënat sipas tabelës që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

**LISTA E PRONARËVE ME REFLEKTIMIN E NDRYSHIMEVE PËR SHPRONËSIM PËR
EFEKT TË NDËRTIMIT TË LTL 400 KV TIRANË-PODGORICË QARKU LEZHË**

Nr.	Objekti	Shpronësim definitiv										Vlera totale e kompensimit në lekë	Adresa e pronarit	Dokumentacioni
		Emri	Atësia	Mbiemri	Lloji i pasurisë	Nr. kadastral	Nr. i pasurisë	Nr. i shtyllës	Sasia shpronësim definitiv m ²	Çmimi shitje ZRPP lekë/m ²	Vlera e kompensimit			
4	Lti 400	Zef	Ndue	Ndreca	arë	8/14/1905	112/2	154	111.5	0	282	31.443	Petrelë	Me certifikatë pronësie

VENDIM
Nr. 219, datë 28.3.2012

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 553, DATË 12.8.2004 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR PROCEDURAT DHE KUSHTET PËR DHËNIEN E LEJEVE TË
KONCESIONIT PËR NDËRTIMIN DHE PËRDORIMIN E RAFINERIVE, TË
NAFTËSJELLËSVE E GAZSJELLËSVE”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës të nenit 18 të ligjit nr. 8450, datë 24.2.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”, të ndryshuar, dhe të neneve 124-128 të ligjit nr. 8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave



VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 553, datë 12.8.2004 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, shkronja “a”, e pikës 9, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“a) Leja e koncesionit negociohet dhe përgatitet nga një grup pune me përfaqësues të Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Ministrisë së Financave, Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit, Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe me subjektin kërkues ose përfaqësuesin ligjor të tij.”.

2. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Ministria e Punëve Publike dhe Transportit, Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Ministria e Financave, Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe Ministria e Drejtësisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 221, datë 28.3.2012

PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE TEKNIKE “PËR ETIKETIMIN E PRODUKTEVE TË QELQIT KRISTAL”¹

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 5 të ligjit nr. 10 489, datë 15.12.2011 “Për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e rregullave teknike “Për etiketimin e produkteve të qelqit kristal”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data 1 janar 2013.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

¹ Ky projektvendim përfron Direktivën Europiane nr. 69/493/EEC “Për produktet e qelqit Kristal”.

RREGULL TEKNIK PËR ETIKETIMIN E PRODUKTEVE TË QELQIT KRISTAL

1. Ky rregull teknik zbatohet për produktet që mbulohen nga kreu nr. 70.13 i Nomenklaturës së Kombinuar të Mallrave.

2. Operatorët ekonomikë sipas rolit dhe përgjegjësisë së tyre sigurojnë që përbërja, karakteristikat e prodhimit dhe etiketimit të produkteve të referuara në pikën 1, si dhe të gjitha format e publicitetit/reklamimit për këto produkte, janë në përputhje me kërkesat e përcaktuara në këtë rregull teknik.

3. Struktura përgjegjëse e mbikëqyrjes së tregut merr masat e parashikuara në legjislacionin për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore, për të ndaluar përdorimin e përshkrimeve të dhënë në kolonën (b) të tabelës së dhënë në shtojcën 1 të këtij rregulli teknik, me qëllim tregtimin e produkteve të cilat nuk kanë karakteristikat përkatëse të përcaktuara në kolonat (d) deri (g) të tabelës së dhënë në shtojcën 1 të këtij rregulli teknik.

4. Në qoftë se produkti i mbuluar nga këto rregulla teknike mban një nga përshkrimet e renditura në kolonën (b) të tabelës së dhënë në shtojcën 1 të rregullave teknike, ai mund të mbajë gjithashtu simbolin identifikues përkatës të dhënë dhe përshkruar në kolonat (h) dhe (i) të tabelës së dhënë në shtojcën 1 të këtij rregulli teknik.

5. Kur një markë tregtare, emri i sipërmarrjes ose çdo mbishkrim tjetër përmban, si pjesë kryesore, si mbiemër ose burim, një nga përshkrimet e dhëna në kolonat (b) dhe (c) të tabelës së dhënë në shtojcën 1 të këtij rregulli teknik, ose një përshkrim që shkakton konfuzion, prodhuesi, përfaqësuesi i tij i autorizuar apo importuesi sigurojnë që marka tregtare, emri ose mbishkrimi shoqërohet menjëherë nga shënimet me germa të dukshme, të mëposhtme:

a) Përshkrimi i produktit, kur ky produkt ka karakteristikat e përcaktuara në kolonat (d) deri (g) të tabelës së dhënë në shtojcën 1 të këtij rregulli;

b) Një deklaratë të natyrës së saktë të produktit, kur ky produkt nuk ka karakteristikat e përcaktuara në kolonat (d) deri (g) të tabelës së dhënë në shtojcën 1 të këtij rregulli.



6. Emrat e kategorive të qelqit dhe simbolet identifikuese të dhëna në tabelë në shtojcën 1 të këtij rregulli teknik, jepen në një etiketë të vetme.

7. Metodat e përcaktuara në shtojcën 2 të këtij rregulli teknik, janë të vetmet metoda, që përdoren nga struktura përgjegjëse për mbikëqyrjen e tregut për të verifikuar se produktet që mbajnë përshkrimet dhe simbolet identifikuese kanë karakteristikat përkatëse të përcaktuara në kolonat (d) deri (g) të tabelës së dhënë në shtojcën 1 të këtij rregulli.



Shtojca 1

Tabela e kategorive të qelqit

Nr.	Përshkrimi i kategorisë (kategoria dhe emri)		Karakteristikat (vetitë fizike dhe kimike)				Etiketa	
		Te dhëna shpjeguese	Oksidet e metaleve (%)	Densiteti (g.cm ⁻³)	Treguesi i thyerjes	Fortësia	Simboli	Shënim
a	b	c	d	e	f	g	h	i
1.	Qelqi kristal me përmbajtje të lartë të plumbit Pb 30%	Përshkrimi mund të jetë lehtësisht/i lirë i përdorshëm cilido qoftë vendi i origjinës apo vendi destination. Përqindja e dhënë i referohet përmbajtjes së oksidit të plumbit (II) PbO	PbO ≥ 30 %	≥ 3.00	x			Rreth me ngjyrë të verdhë flori Diametër ≥ 1 cm
2.	Qelq kristal me përmbajtje plumbi Pb 24 %		PbO ≥ 24%	≥ 2.90	x			
3.	Qelqi kristal "kristalinë"	Janë përdorur vetëm përshkrimet në gjuhën ose gjuhët e vendit në të cilën tregtohen mallrat.	Më vete ose së bashku ZnO, BaO PbO, K ₂ O ≥10%	≥ 2,45	nD ≥1,520			Katror me ngjyrë gri argjendi Brinjë ≥ 1 cm
4.	Qelqi kristal		Më vete ose së bashku BaO, PbO, K ₂ O ≥10%	≥ 2,40		Vickers - 550 ± 20		

X nD ≥1,545 si një kriter për një përcaktim shtesë jo të dëmshëm të produkteve (në kohën e importimit)

SHTOJCA 2
METODAT
PËR PËRCAKTIMIN E VETIVE KIMIKE DHE FIZIKE TË KATEGORIVE TË QELQIT
KRISTAL

1. Analizat kimike

1.1 BaO dhe PbO

1.1.1 Përcaktimi i kombinimit BaO + PbO

Peshohet rreth 0.5 gram qelq i pluhurzuar me saktësi deri në 0.0001 gram, dhe vendoset në një enë platini. Njomet me ujë dhe shtohet 10 mililitra acid sulfurik 15 % dhe 10 mililitra acid fluorhidrik. Nxehet në një banjë rëre derisa të lëshojë avuj me ngjyrë të bardhë.

Lihet të ftohet dhe trajtohet përsëri me 10 mililitra acid fluorhidrik. Nxehet derisa të rishfaqen përsëri avuj të bardhë. Lihet të ftohet përsëri dhe faqet e enës shpëlahen me ujë. Nxehet derisa të rishfaqen përsëri avuj të bardhë. Lihet të ftohet, me kujdes shtohet 10 mililitra ujë, më pas kalohet në një beker me vëllim 400 ml. Shpëlahet ena disa herë me tretësirë acid sulfurik 10 % dhe hollohet deri në 100 ml me të njëjtën tretësirë. Vlohet për 2 deri në 3 minuta. Lihet të qëndrojë në qetësi gjithë natën.

Kalohet nëpër një pot filtrimi me porozitet 4, fillimisht lahet e gjitha me tretësirë të acidit sulfurik 10%, pastaj 2 ose 3 herë me alkool etilik. Thahet në furrë për një orë në temperaturën 150 °C. Peshohet BaSO₄ + PbSO₄.

1.1.2 Përcaktimi i oksidit të bariumit BaO

Peshohet rreth 0.5 gram qelq i pluhurzuar me saktësi deri në 0.0001 gram, dhe vendoset në një enë platini. Njomet me ujë dhe shtohet 10 mililitra acid fluorhidrik dhe 5 mililitra acid perklorik. Nxehet në një banjo rëre deri sa të shfaqen avuj të bardhë.

Lihet të ftohet dhe shtohet një tjetër masë acidi fluorhidrik 10 mililitër. Nxehet derisa të rishfaqen avujt e bardhë. Lihet të ftohet dhe shpëlahen faqet e enës me ujë të distiluar. Nxehet përsëri dhe avullohet pothuaj deri në tharje. Fillohet përsëri me 50 mililitra tretësirë 10 % të acidit klorhidrik dhe nxehet lehtësisht për të ndihmuar tretjen. Kalohet në një beker me vëllim 400 ml dhe hollohet deri në 200 ml me ujë. Vendoset të vlejë dhe nëpër tretësirën e nxehtë kalohet një rrymë gaz sulfhidrik. Kur grimca të precipitatit të sulfurit të plumbit bien në fund të bekerit, mbyllet gazi sulfhidrik. Kalohet nëpër një letër filtri të hollë dhe lahet me ujë të ftohtë të ngopur me gaz sulfhidrik. Vlohet filtrati dhe më pas, në se është e nevojshme, reduktohet deri në 300 mililitra. Shtohet në tretësirën që zien 10 mililitra tretësirë acid sulfurik 10 %. Hiqet nga vlimi dhe lihet të qëndrojë për më pak se 4 orë. Më pas kalohet nëpër një letër filtri të hollë, lahet me ujë të ftohtë. Precipitati kalcinohet në temperaturën 1050°C dhe peshohet BaSO₄.

1.2 Përcaktimi i oksidit të zinkut ZnO

Filtratet e marra nga ndarja e BaSO₄ avullohen deri sa të reduktohen deri në vëllimin 200 mililitra. Neutralizohet me amoniak në prani të metilit të kuq dhe shtohet 20 mililitra acid sulfurik N/10. Rregullohet pH 2 (me pH metër) me shtimin e acidit sulfurik N/10 ose sodës kaustike sipas rastit, dhe nga kalimi në të ftohtë i një rryme gazi sulfhidrik precipiton sulfurit i zinkut.

Precipitati lihet të qëndrojë në qetësi për katër orë, më pas mblidhet në një letër filtri të hollë. Lahet mirë me ujë të ftohtë të ngopur me gaz sulfhidrik. Precipitati tretet mbi filtër duke derdhur nëpër të 25 mililitra tretësirë 10% acidi klorhidrik të nxehtë. Lahet filtri me ujë të vluar derisa të merret vëllimi rreth 150 mililitra. Neutralizohet me amoniak në prani të letrës së lakmuesit, e më pas shtohet 1-2 gramë tretësirë *puffer urotropinë* e ngurtë (C₆H₁₂N₄) me pH 5. Shtohen disa pika të tretësirës ujore 0.5 % të ksilenol (dimetilfenol) portokalli i sapo përgatitur dhe titullohet me tretësirë të Kompleksonit III (N/10) derisa të ndryshojë ngjyra nga rozë në të verdhë limoni.

1.3 Përcaktimi i oksidit të kaliumit K₂O nga precipitimi dhe peshimi i tetra fenilboratit të kaliumit.



Procedura. Pas dërrmimit dhe sitosjes 2 gramë qelq, trajtohen me 2 mililitra HNO_3 të përqëndruar, 15 mililitra perklorat azoti NClO_4 , 25 mililitra acid fluorhidrik në një enë platini mbi një banjo uji e më pas në një banjo rëre. Pas shfaqjes së avujve të dendur të acidit perklorik (në mënyrë të vazhdueshme derisa thahet), tretet me 20 mililitra ujë të nxehtë dhe 2-3 mililitra acid klorhidrik të përqëndruar. Hidhet në një balon të taruar me vëllim 200 mililitër dhe plotësohet vëllimi me ujë të distiluar.

Reagentët. Tretësira 6% e tetrafenilboratit të natriumit: tretet 1.5 gram reagent në 250 mililitra ujë të distiluar. Largohet turbullira e lehtë e cila mbetet nga shtimi i 1 gram hidroksid alumini. Tundet për pesë minuta dhe filtrohet, duke pasur kujdes rifiltrohen 20 mililitrat e para të marra.

Tretësira larëse për precipitatin: përgatitet pak kripë kaliumi nga precipitimi në tretësirë e rreth 0.1 gram KCl në 50 mililitra HCl N/10 (0.1 N) në të cilën hidhet tretësira e tetrafenil boratit duke e përzierë, derisa përfundon precipitimi. Filtrohet nëpër një sinter. Lahet me ujë të distiluar. Thahet në eksikator në temperaturën e dhomës. Më pas hidhet 20-30 miligram të kësaj kripe në 250 mililitra ujë të distiluar. Përzihet herë pas here. Pas tridhjetë minutave shtohet 0.5 -1 gram hidroksid alumini $\text{Al}(\text{OH})_3$. Përzihet për pak minuta. Filtrohet.

Metoda e veprimt. Merret një alikuot e acidit tretës që i korrespondon rreth 10 mg e K_2O . Hollohet me rreth 100 mililitra. Shtohet ngadalë tretësira reagent, rreth 10 ml për 5 miligram të supozuar të K_2O duke e përzierë lehtësisht. Lihet të qëndrojë maksimumi 15 minuta pastaj filtrohet nëpërmjet një pot porcelani të sintetizuar dhe taruar me porozitet 3 ose 4. Lahet me tretësirë larëse. Thahet për 30 minuta në 120°C . Konvertohet faktori 0.13143 për K_2O .

1.4 Tolerancat

Tolerancat do të jenë ± 0.1 në vlerë absolute për çdo përcaktim. Në qoftë se përcaktimet japin vlera më të vogla se kufijtë e vendosur (30, 24, ose 10 %), brenda tolerancës, merret mesatarja e të paktën tre përcaktimeve. Në se mesatarja është më e madhe ose e barabartë përkatësisht me 29.95%, 23.95%, ose 9.95%, qelqi pranohet përkatësisht në kategoritë që i korrespondojnë 30, 24, dhe 10 %.

2. Përcaktimet fizike

2.1 Densiteti (pesha specifike)

Metoda me peshoren hidrostatike me tolerancë deri në ± 0.01 . Një mostër të paktën 20 gram është peshuar në ajër dhe e peshuar e përzierë në ujë të distiluar në temperaturën 20°C .

2.2 Treguesi i thyerjes

Treguesi matet me refraktometër me tolerancë ± 0.001 .

2.3 Fortësia

Fortësia *Vickers* është njehsuar sipas standardit ASTM E 92-65 ose standardeve shqiptare të njëvlershme me të, duke përdorur një peshë 50 gramë, duke marrë mesataren e 15 përcaktimeve.

VENDIM
Nr. 222, datë 28.3.2012

PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE TEKNIKE PËR ETIKETIMIN E MATERIALEVE QË PËRDOREN NË PËRBËRËSIT KRYESORË TË VESHJEVE TË KËMBËS, NË SHITJE PËR KONSUMATORËT¹

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 5 të ligjit nr. 10 489, datë 15.12.2011 “Mbi tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e rregullave teknike për etiketimin e materialeve që përdoren në përbërësit kryesorë të veshjeve të këmbës, në shitje për konsumatorët, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data 1 janar 2013.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

RREGULL TEKNIK
MBI ETIKETIMIN E MATERIALEVE QE PËRDOREN NË PËRBËRËSIT KRYESORË TË VESHJEVE TË KËMBËS NË SHITJE PËR KONSUMATORËT

1. Ky rregull teknik zbatohet për etiketimin e materialeve të cilat përdoren në përbërësit kryesorë të veshjeve të këmbës që vihen në shitje për konsumatorët.

2. Ky rregull teknik nuk zbatohet për:

- a) veshje këmbë të përdorura;
- b) veshje këmbë mbrojtëse të mbuluara nga rregulli teknik “Për kërkesat thelbësore dhe vlerësimin e konformitetit të pajisjeve mbrojtëse personale”;
- c) veshje këmbë të mbuluara nga legjislacioni për substancat kimike;
- ç) veshje këmbë që përdoren në lodra.

3. Për qëllime të këtij rregulli teknik, termat e mëposhtëm nënkuptojnë:

a) “Veshje këmbë” janë të gjithë artikujt me shollë të parashikuara për të mbrojtur ose mbuluar këmbën, përfshirë edhe pjesët që tregtohen veçmas të përcaktuara në pikën 15 të këtij rregulli teknik.

b) “Pjesa e sipërme” është pjesa e sipërme e elementit strukturor, e cila i bashkëngjitet pjesës së poshtme të veshjes së këmbës.

c) “Veshja e brendshme dhe astari” është veshja e brendshme e pjesës së sipërme dhe shtroja, të cilat përbëjnë pjesën e brendshme të veshjes së këmbës.

ç) “Pjesa e poshtme” është pjesa e poshtme e veshjes së këmbës, e cila është objekt i fërkimit dhe i bashkëngjitet pjesës së sipërme.

d) “Lëkurë” është term i përgjithshëm që përdoret për gëzofin ose lëkurën me strukturën

¹ Ky projektvendim përafuron direktivën nr. 94/11/EC të Parlamentit Europian dhe Këshillit, të 23 marsit 1994, mbi përafrimin e ligjeve, rregulloreve dhe dispozitave administrative të shteteve anëtare në lidhje me etiketimin e materialeve të përdorura në përbërësit kryesorë të veshjeve të këmbës, në shitje për konsumatorët.



fibroze origjinale të saj, pak a shumë të paprekur, e staxhionuar për të qenë rezistente ndaj kalbëzimit. Fija ose leshi i lëkurës mund të hiqet ose mund të mos hiqet. Lëkura, gjithashtu është e përbërë nga gëzof ose lëkurë, e cila është ndarë në shtresa ose e segmentuar, përpara ose pas staxhionimit. Megjithatë, nëse gëzofi i staxhionuar ose lëkura është shpërbërë mekanikisht dhe/ose kimikisht në copëza fijesh, pjesë të vogla ose pluhura dhe më pas, me ose pa kombinimin e agjentëve lidhës, është kthyer në shtresa ose forma të tjera, shtresa ose forma të tilla nuk janë lëkurë. Nëse lëkura ka një shtresë sipërfaqësore, të aplikuar ose të vulosur/ngjitur në fund, një shtresë e tillë sipërfaqësore nuk duhet të jetë më e trashë se 0.15mm.

dh) “Lëkurë e vërtetë(lëkurë origjinale)” është lëkurë që përbëhet nga lëndë origjinale, e cila ekspozohet nga heqja e shtresës së jashtme të lëkurës, por jo nëpërmjet lëmimit, rrjepjes ose ndarjes. Ky term përdoret në informacionin shtesë në formë teksti që mund të shoqërojë veshjen e këmbës.

e) “Lëkurë e mbuluar” është lëkura ku sipërfaqja e mbuluar e aplikuar në lëkurë nuk e kalon një të tretën e trashësisë së totalit të produktit, por është më e madhe se 0.15 mm.

ë) “Tekstile” është çdo material, gjysmë i punuar, i punuar, gjysmë i fabrikuar, i fabrikuar, produkt gjysmë i përgatitur/i gatshëm ose i përgatitur/i gatshëm të cilët janë ekskluzivisht të përbërë nga fibra tekstile, pavarësisht procesit të përdorur të përzierjes ose bashkimit.

4. Informacioni mbi përbërjen e veshjes së këmbës jepet nëpërmjet etiketës.

a) Etiketa jep informacion për tri pjesë të veshjes së këmbës, përkatësisht:

i) pjesën e sipërme;

ii) veshjen e brendshme dhe astarin; si dhe

iii) pjesën e poshtme.

b) Përbërja e veshjes së këmbës tregohet sipas përcaktimit në pikën 8, 9, 10 dhe 11, në bazë të piktogramave ose treguesve të shkruar për materiale të veçanta, të përcaktuara në pikën 15 të këtij rregulli teknik.

c) Në rastin e pjesës së sipërme të veshjes së këmbës, klasifikimi i materialeve përcaktohet sipas pikës 8 dhe 15, pa përfshirë pajisje shtesë ose përforcuesit e kyçeve të këmbës, bordurat, zburimet, tokëzat, lidhëset, unazat e lidhëseve ose aksesore të ngjashëm.

ç) Në rastin e pjesës së poshtme, klasifikimi bazohet në vëllimin e materialeve të përfshira në të, në përputhje me pikën 8, 9, 10 dhe 11.

5. Struktura përgjegjëse e mbikëqyrjes së tregut e parashikuar në legjislacionin për sigurinë e përgjithshme të produkteve, si dhe në atë për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve jo ushqimore, është përgjegjëse për të siguruar që të gjitha veshjet e këmbës të vendosura në treg plotësojnë kërkesat për etiketimin të përcaktuara në këtë rregull teknik.

6. Kur veshjet e këmbës të vendosura në treg nuk janë në përputhje me kërkesat për etiketimin, struktura përgjegjëse për mbikëqyrjen e tregut merr masat e parashikuara në legjislacionin për sigurinë e përgjithshme, tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore.

7. Nuk ndalohet ose pengohet vendosja në treg e veshjeve të këmbëve të cilat janë në përputhje me kërkesat e etiketimit të përcaktuara në këtë rregull teknik.

8. Etiketi jep informacionin për materialet e përcaktuara në pikën 15 të këtij rregulli teknik, i cili përbën të paktën 80% të sipërfaqes së pjesës së sipërme, veshjes së brendshme dhe astarit të veshjeve të këmbës dhe të paktën 80% të vëllimit të pjesës së poshtme. Në qoftë se asnjë material nuk përbën të paktën 80%, informacioni jepet për të dyja materialet kryesore të përdorura në përbërjen e veshjeve të këmbës.

9. Informacioni jepet në veshjen e këmbës. Prodhuesi ose përfaqësuesi i tij, i autorizuar mund të zgjedhë ose piktogramat ose treguesit e shkruar në gjuhën shqipe. Piktogramet në lidhje me materialet paraqiten në etiketë pranë piktogramave të lidhura me tri pjesët e veshjes së këmbës.

10. Për qëllime të këtij rregulli teknik, etiketimi përfshin vendosjen e informacionit të kërkuar në të paktën një artikull të veshjes së këmbës për çdo palë. Kjo mund të bëhet nëpërmjet printimit, ngjites, stampimit ose përdorimit të etiketës së bashkëngjitur.

11. Etiketimi duhet të jetë i bashkëngjitur në mënyrë të sigurt, qartësisht i dukshëm dhe dimensionet e piktogrameve duhet të jenë mjaftueshëm të mëdha, për të kuptuar lehtësisht informacionin e dhënë në të. Etiketimi nuk duhet të çorientojë konsumatorin.

12. Prodhuesi ose përfaqësuesi i tij, i autorizuar është përgjegjës për sigurimin e etiketave dhe saktësinë e informacionit të dhënë në të. Në qoftë se as prodhuesi dhe as përfaqësuesi i tij i autorizuar nuk është i vendosur në Shqipëri, përgjegjës do të jetë importuesi ose personi që vendos për herë të parë veshjen e këmbës në treg. Shitësi është përgjegjës për të siguruar se veshja e këmbës që ai vë në shitje prej tij mban etiketën në përputhje me kërkesat e këtij rregulli teknik.

13. Në kushte të caktuara etiketës me informacionin e dhënë, e cila është në përputhje me kërkesat e këtij rregulli teknik, i bashkëngjitet informacioni shtesë në formë teksti. Mungesa e këtij informacioni shtesë nuk pengon vendosjen në treg të veshjeve të këmbës që janë në përputhje me kërkesat e etiketimit të përcaktuara në këtë rregull teknik.

14. Lloje veshjeje këmbësh të mbuluara nga ky rregull teknik janë veshjet e këmbës të cilat mund të variojnë nga sandalet me pjesën e sipërme të përbërë nga lidhëse të thjeshta, të përshtatshme ose copë, deri te çizmet e gjata deri në kofshë, pjesa e sipërme e së cilave mbulon këmbën dhe kofshën. Ndër produktet e përfshira për këtë arsye janë:

a) këpucë të sheshta ose me takë të lartë për veshje të zakonshme shtëpie ose jashtë shtëpie;
b) çizme deri te kyçi këmbës, gjysmëçizme, çizme deri te gjuri, çizme deri te kofsha;
c) sandale të llojeve të ndryshme, këpucë në pjesën e sipërme me kanavacë dhe në pjesën e poshtme me materiale perimesh të gërshetuara, këpucë tenisi, këpucë vrapi dhe këpucë të tjera sportive, sandale banje dhe veshje të tjera këmbësh sipas rastit;

ç) veshje këmbë të veçanta sportive të cilat janë dizenuar për aktivitete sportive, të cilat kanë ose parashikojnë bashkëngjitjen e thikave, perçinave, kunjave, kapëseve zbukuroese, shufrave ose të ngjashme me to dhe çizmet e patinazhit, çizmet e skive dhe veshje këmbë skish për aktivitete të veçanta sportive, çizme për mundje, çizmet e boksit dhe këpucët e çiklizmit. Gjithashtu janë të përfshirë artikujt të përbërë nga veshje këmbë me (akull ose rul) patina bashkëngjitur;

d) këpucët e baletit;

dh) këpucë të formuara nga një copë e vetme, veçanërisht të formuara nga goma apo plastika, por duke përfshirë artikujt e disponueshëm prej materialit të lehtë (letër, film plastik, etj., pa shollë);

e) “mbikëpucë” që vishen sipër një veshjeje këmbë tjetër, të cilat në disa raste janë me pak takë;

ë) veshje këmbë me shollë, përgjithësisht të parashikuara për t’u përdorur vetëm një herë;

f) veshje këmbë ortopedike; si dhe

g) produktet e mbuluara nga kapitulli 64, i Nomenklaturës së Kombinar të mallrave.

15. Treguesit e shkruar dhe piktogramet përkatëse të pjesëve përbërëse të veshjes së këmbës dhe të materialeve përbërëse të veshjeve të këmbës janë:



a)Për pjesën e sipërme	Treguesit e shkruar Pjesa e sipërme	Piktogramet Figura 1
b)Për veshjen e brendshme dhe astarin	Veshja e brendshme dhe astari	Figura 2
c)Për pjesën e poshtme	Pjesa e poshtme	Figura 3
a)Për lëkurën	Lëkurë	Figura 1
b)Për lëkurën e mbuluar	Lëkurë e mbuluar	Figura 2
c)Për tekstile	Tekstile	Figura 3
ç)Për materiale të tjera	Materiale të tjera	Figura 4

VENDIM
Nr. 223, datë 28.3.2012

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 23, DATË 11.1.2012 “PËR KUOTAT E PRANIMIT DHE TARIFAT E SHKOLLIMIT PËR CIKLIN E DYTË TË STUDIMEVE “MASTER PROFESIONAL”, ME KOHË TË PJESSHME, DHE EDUKIMIN NË DISTANCË, NË INSTITUCIONET PUBLIKE TË ARSIMIT TË LARTË, NË VITIN AKADEMIK 2011-2012”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 33, 35, 36 e 75 të ligjit nr. 9741, datë 21.5.2007 “Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të ligjit nr. 7889, datë 14.12.1994 “Për statusin e invalidit” të ligjit nr. 8626, datë 22.6.2000 “Për statusin e invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik”, të ndryshuar, të ligjit nr. 10 289, datë 17.6.2010 “Për mënyrën e trajtimit ekonomik e financiar dhe për dhënie ndihme të menjëhershme familjeve të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit, të Forcave të Armatosura, të Shërbimit Informativ Shtetëror dhe të Policisë së Burgjeve, që humbin jetën në krye apo për shkak të detyrës”, të ligjit nr. 8153, datë 31.10.1996 “Për statusin e jetimit”, të ndryshuar, të ligjit nr. 8098, datë 28.3.1996 “Për statusin e të verbrit” dhe të ligjit nr. 7748, datë 29.7.1993 “Për statusin e ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë nga sistemi komunist”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe të Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pika 1 e vendimit nr. 23, datë 11.1.2012 të Këshillit të Ministrave, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“1. Kuota e përgjithshme e pranimeve në institucionet publike të arsimit të lartë, për studimet e ciklit të dytë “Master Profesional”, me kohë të pjesshme, dhe edukimin në distancë, për vitin akademik 2011-2012, të jetë 1400, e cila ndahet, si më poshtë vijon:

- | | |
|---|-------|
| a) Kuota e pranimeve të reja në programet e studimit të ciklit të dytë, me kohë të pjesshme | 1260, |
| b) Kuotat për transferim studimesh | 40, |
| c) Kuota për shqiptarë nga trojet jashtë kufijve të vendit dhe shtetas të tjerë të huaj | 60, |
| ç) Kuota për ish – të përndjekurit politikë | 40.”. |

2. Kuotat shtesë, sipas shkronjës “a”, të pikës 1 të këtij vendimi të akordohen për Universitetin Politeknik të Tiranës, sipas tabelës 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

3. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Institucionet Publike të Arsimit të Lartë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Tabela nr.1

Kuota dhe tarifa për programin master profesional të UPT, sistemi me kohë të pjesshme,
2011-2012

Universiteti/emërtimi	Nr.	Emërtimi i programit të studimit	Kuota	Tarifa për kredit (në lekë)	Tarifa totale (në lekë)
Universiteti Politeknik i Tiranës	15	Planifikimi i sistemeve të transportit, menaxhimi i trafikut dhe siguria rrugore	30	728	65,520



VENDIM
Nr. 224, datë 28.3.2012

**PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 473, DATË 16.7.2004 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË
PALUAJTSHME SHTETËRORE NË KOMUNËN E ISHMIT” DHE PËR NJË SHITESË NË
VENDIMIN NR. 284, DATË 12.3.2008 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR
MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PYJEVE DHE KULLOTAVE QË DO TË
TRANSFEROHEN NË PRONËSI TË NJËSISË SË QEVERISJES VENDORE, KOMUNA
ISHËM, TË QARKUT TË DURRËSIT”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, dhe të nenit 23 të ligjit nr. 9385, datë 4.5.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, me propozimin e Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe të Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës shtesë të inventarit të pronave të paluajtshme, pyje dhe kullota, në territorin administrativ të komunës Ishëm. Lista është me 1 (një) fletë e përfundon me numër rendor 2.

2. Miratimin e listës shtesë të pronave të paluajtshme publike, pyje dhe kullota, që transferohen në pronësi të kësaj njësie. Lista është me 5 (pesë) fletë, dhe përfundon me numër rendor 129.

3. Ndryshimet në listën e inventarit dhe në listën përfundimtare të pyjeve dhe kullotave, që transferohen në pronësi, si dhe lidhja nr.1 (një), i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij.

4. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe komuna Ishëm, e qarkut të Durrësit, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Njësia e qeverisjes vendore Ishëm, qarku Durrës

Lidhja nr. 1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transfertimit
37-65,79-88,146-159,161-162	Pyll, trungishte, cungishte, shkurre	Pronësi
164-165,167,171-180,192-200		
207-240,262-265,269-273		
291-292,296-300,550-551		

VENDIM
Nr. 226, datë 9.4.2012

**PËR RISHPËRNDARJE NË NUMRIN E PUNONJËSVE DHE TË FONDEVE BUXHETORE,
MIRATUAR PËR VITIN 2012, NGA SHËRBIMI INFORMATIV I SHTETIT TE
MINISTRIA E MBROJTJES**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës të shkronjës “a”, të nenit 44 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe të neneve 11 e 17 të ligjit nr. 10 487, datë 5.12.2011 “Për buxhetin e vitit 2012”, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në numrin e përgjithshëm të punonjësve, miratuar për vitin 2012, të bëhet rishpërndarja, si më poshtë vijon:

a) Ministrisë së Mbrojtjes t’i shtohen 7 punonjës për funksionimin e Drejtorisë së Shifrës, si autoriteti kombëtar për sigurimin e komunikimeve dhe autoriteti kombëtar i shpërndarjes, në varësi të kësaj ministrie;

b) Shërbimit Informativ të Shtetit t’i pakësohen 7 punonjës.

2. Në buxhetin e miratuar për vitin 2012 të bëhet rishpërndarja e fondeve, si më poshtë vijon:

a) Shërbimit Informativ të Shtetit në programin me kod 03520 “Veprimtaria informative shtetërore” t’i pakësohet fondi prej 10 000 000 (dhjetë milionë) lekësh, nga i cili: shpenzime korente 9 600 000 (nëntë milionë e gjashtëqind mijë) lekë dhe shpenzime kapitale 400 000 (katërqind mijë) lekë;

b) Ministrisë së Mbrojtjes në programin me kod 01110 “Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi” t’i shtohet fondi prej 10 000 000 (dhjetë milionë) lekësh, nga i cili: shpenzime korente 9 600 000 (nëntë milionë e gjashtëqind mijë) lekë dhe shpenzime kapitale 400 000 (katërqind mijë) lekë.

3. Ngarkohen Ministria e Financave, Ministria e Mbrojtjes dhe Shërbimi Informativ i Shtetit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

URDHËR
Nr. 16, datë 17.1.2012

**PËR RIORGANIZIMIN E FAKULTETIT TË MËSUESISË NË FAKULTETIN E EDUKIMIT
DHE FILOLOGJISË DHE NË FAKULTETIN E SHKENCAVE NATYRORE DHE
SHKENCAVE HUMANE NË UNIVERSITETIN “FAN.S.NOLI” KORÇË**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës, të pikave 5 dhe 6 të nenit 41 dhe pikës 1 të nenit 42 të ligjit nr. 9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,



URDHËROJ:

1. Riorganizimin e Fakultetit të Mësuesisë të universitetit “Fan.S.Noli” të Korçës në dy fakultete, përkatësisht:

- a) Fakulteti i Edukimit dhe Filologjisë;
- b) Fakulteti i Shkencave Natyrore dhe Shkencave Humane.

2. Fakulteti i Edukimit dhe Filologjisë të ketë në përbërje këto njësi bazë:

- a) Departamenti i gjuhë-letërsisë;
- b) Departamenti i gjuhëve të huaja;
- c) Departamenti i psikologji-pedagogjisë dhe histori-gjeografisë.

3. Fakulteti i Edukimit dhe Filologjisë ofron programe studimi të ciklit të parë, që realizohen me 180 kredite, me kohëzgjatje normale 3 vite akademike, në përfundim të të cilave lëshohet diplomë universitare “Bachelor”, në:

- a) Cikël i ulët;
- b) Cikël i ulët parashkollor;
- c) Histori-gjeografi;
- d) Gjuhë-letërsi;
- e) Gjuhë angleze;
- f) Cikël i ulët dhe anglisht (filiali Pogradec);
- g) Gjuhë-letërsi shqipe dhe frënge.

4. Fakulteti i Edukimit dhe Filologjisë ofron programe studimi të ciklit të dytë, që realizohen me 90 kredite me kohëzgjatje normale 1,5 (një vit e gjashtë muaj) vite akademike, në përfundim të të cilave lëshohet diplomë “Master profesional”, në:

- a) Gjuhë angleze;
- b) Gjuhë-letërsi, me profil minor në sporte;
- c) Gjuhë-letërsi, me profil minor në arte;
- d) Master profesional për shkollat profesionale.

5. Fakulteti i Shkencave Natyrore dhe Shkencave Humane të ketë në përbërje këto njësi bazë:

- a) Departamenti i matematikës;
- b) Departamenti i informatikës dhe fizikës;
- c) Departamenti i infermierisë;
- d) Departamenti i shkencave sociale.

6. Fakulteti i Shkencave Natyrore dhe Shkencave Humane ofron programe studimi të ciklit të parë, që realizohen me 180 kredite, me kohëzgjatje normale 3 vite akademike, në përfundim të të cilave lëshohet diplomë “Bachelor”, në:

- a) Matematikë-fizikë;
- b) Matematikë-informatikë;
- c) Teknologji informacioni;
- d) Biologji-kimi;
- e) Filozofi-sociologji;
- f) Infermier i përgjithshëm;
- g) Infermier mami.

7. Fakulteti i Shkencave Natyrore dhe Shkencave Humane, ofron programe studimi të ciklit të dytë, që realizohen me 90 kredite me kohëzgjatje normale 1,5 (një vit e gjashtë muaj) vite akademike, në përfundim të të cilave lëshohet diplomë “Master profesional”, në:

- a) Filozofi-sociologji, me profil minor në “Edukim qytetar”;
- b) Matematikë-fizikë, me profil minor në “Informatikë”.

8. Fakulteti i Shkencave Natyrore dhe Shkencave Humane ofron programin e studimit të ciklit të dytë, që realizohet me 120 kredite, ku përfshihen 30-40 kredite për projektin kërkimor dhe tezën me kohëzgjatje normale 2 vite akademike, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë “Master i shkencave”, në:

a) Filozofi sociale.

9. Efektet financiare për zbatimin e këtij urdhri përballohen nga buxheti i universitetit “Fan.S.Noli”, Korçë, pa efekte buxhetore shtesë.

10. Ngarkohen Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, si dhe universiteti “Fan.S.Noli” i Korçës, për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS
Myqerem Tafaj

URDHËR
Nr.92, datë 15.3.2012

**PËR RIORGANIZIMIN STRUKTUROR NGA “FAKULTETI I DREJTËSISË” DHE
“FAKULTETI I SHKENCAVE SOCIALE” TË SHKOLLËS SË LARTË UNIVERSITARE
PRIVATE “UNIVERSITETI KRISTAL”, NË NJË FAKULTET TË VETËM “FAKULTETI I
DREJTËSISË DHE SHKENCAVE SOCIALE”**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikave 5 dhe 6 të nenit 41 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr.761, datë 6.12.2005 “Për dhënien e lejes për hapjen e shkollës së lartë universitare, jopublike “Universiteti Kristal””,

URDHËROJ:

1. Riorganizimin strukturor nga “Fakulteti i Drejtësisë” dhe “Fakulteti i Shkencave Sociale” të shkollës së lartë universitare private “Universiteti Kristal”, në një fakultet të vetëm “Fakulteti i Drejtësisë dhe Shkencave Sociale” në përputhje me vendimin nr.298, datë 13.1.2012 të Këshillit të Akreditimit të Arsimit të Lartë “Për riorganizimin strukturor të Fakultetit të Drejtësisë dhe shkencave sociale, të shkollës së lartë private “Kristal””, bashkëlidhur këtij urdhri.

2. Fakulteti i Drejtësisë dhe Shkencave Sociale të ketë në përbërje këto njësi bazë:

a) Departamenti i së Drejtës Publike;

b) Departamenti i së Drejtës Private;

c) Departamenti i Shkencave Sociale;

d) Departamenti i Psikologjisë dhe Sociologjisë.

3. Ky institucion duhet t’i nënshtrohet procesit të akreditimit institucional, brenda afateve të përcaktuara në ligjin në fuqi.

4. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë, Këshilli i Akreditimit, Drejtoria e Zhvillimit të Arsimit Jopublik dhe shkolla e lartë universitare private “Universiteti Kristal”.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS
Myqerem Tafaj



URDHËR
Nr. 102, datë 21.3.2012

**PËR HAPJEN E PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR NË
“PSIKOLOGJI”, PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË MASTER I
SHKENCAVE NË “ARKITEKTURË” TË INSTITUCIONIT TË ARSIMIT TË LARTË
PRIVAT “UNIVERSITETI AMERIKAN I TIRANËS”**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të nenit 42/1 të ligjit nr. 9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Hapjen, në përputhje me vendimin nr. 267, datë 4.11.2011 të Këshillit të Akreditimit, në institucionin e arsimit të lartë privat “Universiteti Amerikan i Tiranës”, të programit të studimit të ciklit të parë, *bachelor* në “Psikologji” pranë Fakultetit të Shkencave Shoqërore dhe të Edukimit.

2. Programi i studimit i përcaktuar në pikën 1 të këtij urdhri, realizohet me 180 kredite, dhe kohëzgjatja normale është 3 vite akademike. Në përfundim të tij lëshohet diplomë universitare “*Bachelor*”, në “Psikologji”.

3. Hapjen, në përputhje me vendimin nr. 267, datë 4.11.2011 të Këshillit të Akreditimit, në institucionin e arsimit të lartë privat “Universiteti Amerikan i Tiranës”, i programit të studimit të ciklit të dytë “Master i shkencave” në “Arkitekturë” pranë Fakultetit të Arkitekturës dhe Arteve Figurative.

4. Programi i studimeve i përcaktuar në pikën 3 të këtij urdhri, realizohet me 300 kredite dhe kohëzgjatja normale e tij është 5 vite akademike. Në përfundim të tij lëshohet diplomë universitare “Master i shkencave” në “Arkitekturë”.

5. Programet e studimeve të fillojnë në vitin akademik 2012-2013.

6. Ky institucion duhet t’i nënshtrohet procesit të akreditimit, brenda afateve të përcaktuara në ligjin në fuqi.

7. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë, Agjencia Kombëtare e Provimeve, Drejtorja e Zhvillimit të Arsimit Privat dhe shkolla e lartë private “Universiteti Amerikan i Tiranës”.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS
Myqerem Tafaj

URDHËR
Nr. 124, datë 29.3.2012

**PËR AKREDITIMIN INSTITUCIONAL DHE TË PROGRAMEVE TË STUDIMIT
“BACHELOR” NË “EKONOMI”, “MARRËDHËNIE NDËRKOMBËTARE/DIPLOMACI”,
“SHKENCA POLITIKE-ADMINISTRATË PUBLIKE” TË INSTITUCIONIT “SHKOLLA E
LARTË PRIVATE MESDHETARE E SHQIPËRISË”**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të nenit 62 të ligjit nr. 9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Akreditimin institucional, në përputhje me vendimin nr. 303, datë 13.1.2012 të Këshillit të Akreditimit, të institucionit “Shkolla e Lartë Private Mesdhetare e Shqipërisë”.

2. Akreditimin në përputhje me vendimin nr. 303, datë 13.1.2012 të Këshillit të Akreditimit, në institucionin “Shkolla e Lartë Private Mesdhetare e Shqipërisë”, e programeve të studimit “Bachelor” në:

- a) Ekonomi, me profile:
 - i) Financë-bankë dhe kontabilitet;
 - ii) Administrim biznesi;
 - iii) Biznes dhe ligj.
- b) Marrëdhënie ndërkombëtare/diplomaci;
- c) Shkenca politike-administratë publike, me profile:
 - i) Administratë publike;
 - ii) Shkenca politike.

3. “Shkolla e Lartë Private Mesdhetare e Shqipërisë” të plotësojë rekomandimet e përcaktuara në vendimin nr. 303, datë 13.1.2012 të Këshillit të Akreditimit, bashkëlidhur këtij urdhri dhe të raportojë në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës, për plotësimin e tyre, brenda 6 muajve, nga data e hyrjes në fuqi të këtij urdhri.

4. Programet e studimit të akredituara, të përcaktuara në pikën 2 të këtij urdhri, u nënshtrohen vlerësimit dhe akreditimit periodik. Bazuar në pikën 4 të nenit 62 të ligjit nr. 9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, vlerësimi dhe akreditimi periodik kryhet çdo 6 vjet.

5. Urdhri bëhet publik në faqen zyrtare të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës.

6. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë, Këshilli i Akreditimit, Drejtoria e Zhvillimit të Arsimit Jopublik dhe institucioni “Shkolla e Lartë Private Mesdhetare e Shqipërisë”.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS
Myqerem Tafaj

VENDIM Nr.20, datë 13.4.2012

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	Kryetar i	Gjykatës Kushtetuese		
Vladimir Kristo	Anëtar i	“	“	
Xhezair Zaganjori	Anëtar i	“	“	
Petrit Ploçi	Anëtar i	“	“	
Vitore Tusha	Anëtare e	“	“	
Sokol Berberi	Anëtar i	“	“	
Admir Thanza	Anëtar i	“	“	
Altina Xhoxhaj	Anëtare e	“	“	
Fatmir Hoxha	Anëtar i	“	“	

me sekretare Enina Mullaj, në datën 29.9.2011 mori në shqyrtim në seancë gjyqësore çështjen nr. 30/8 Akti, që i përket:



KËRKUES: Irakli Stefani, përfaqësuar me prokurë nga avokat Theodhori Sollaku.

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Tefik Ismaili, Rexhep Ismaili, përfaqësuar me prokurë nga avokat Arben Rakipi; bashkia Sarandë, në mungesë; Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave Tiranë, në mungesë.

OBJEKTI: Shfuqizimi, si i papajtueshëm me Kushtetutën, i vendimit nr. 00-2009-303 (95), datë 19.3.2009 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 131/f, dhe 134/g të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe neni 6 i Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes, Fatmir Hoxha; përfaqësuesin e kërkuarit, avokat Theodhori Sollakun, që kërkoi pranimin e kërkesës, përfaqësuesin e subjekteve të interesuara; avokat Arben Rakipin, që kërkoi rrëzimin e saj; në mungesë të subjekteve të interesuara, bashkia Sarandë dhe Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave Tiranë, dhe pasi bisedoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Kërkuarit, Irakli Stefani, me vendimin nr. 13, datë 25.7.2000, i është dhënë nga këshilli i bashkisë Sarandë një shesh ndërtimi për stacion radio-televiziv, me sipërfaqe 1890 m², sipas studimit urbanistik të miratuar për këtë shesh nga Këshilli i Rregullimit të Territorit të Bashkisë Sarandë (KRRTS). Me vendimin nr. 57, datë 26.12.2000 të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave Sarandë (KKKPS) i është kthyer z. Servet Ismaili (S.I.), si ish-pronar, sipërfaqja prej 15.6 ha pyll, në të cilën përfshihet plotësisht sipërfaqja që i është dhënë kërkuarit.

2. Kërkuari ka paraqitur kërkesëpadi në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Sarandë për të kundërshtuar vendimin nr. 57, datë 26.12.2000 të KKKPS-së, vetëm për pjesën e pronës që ai posedon (sip. 1890 m²). Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë, me vendimin nr. 455, datë 4.7.2002, ka vendosur rrëzimin e kërkesëpadisë, duke arsyetuar se në mungesë të titullit të pronësisë, kërkuari nuk kishte interes ligjor për ngritjen e padisë.

3. Gjykata e Apelit Gjyrokastër, pas ankimit të kërkuarit dhe personit të tretë, bashkisë Sarandë, me vendimin nr. 443, datë 5.11.2002, ka vendosur prishjen e vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë dhe pushimin e çështjes, duke argumentuar se paditësi nuk legjitimohej, sipas nenit 32/a të Kodit të Procedurës Civile (KPC).

4. Pas rekursit të ushtruar nga kërkuari, Gjykata e Lartë, me vendimin nr. 1908, datë 12.12.2003, ka vendosur mospranimin e rekursit.

5. Ndërkohë prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë regjistroi procedimin penal ndaj shtetasit S.I. për veprën penale të “Falsifikimit dhe përdorimit të dokumenteve të falsifikuara”, parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal (KP). Objekt hetimi nga prokuroria ishte një vërtetim i datës 13.3.1995, i nxjerrë nga Arkivi i Këshillit të Rrethit Sarandë, në bazë të të cilit shtetasi S.I. është njohur si pronar i sipërfaqes prej 15.6 ha të kthyer nga KKKPS-ja. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë, në përfundim të gjykimit, me vendimin nr. 82, datë 10.11.2004, ka shpallur fajtor të pandehurin S.I. për kryerjen e veprës penale të “falsifikimit të dokumentit”. Ky vendim u prish nga Gjykata e Apelit Gjyrokastër për parregullsi procedurale dhe çështja u rikthye për rigjykim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Sarandë, e cila, me vendimin nr. 84, datë 20.10.2006, ka vendosur pushimin e çështjes penale në ngarkim të të pandehurit S.I. për kryerjen e veprës penale të “falsifikimit dhe përdorimit të dokumenteve të falsifikuara” për shkak amnistie.

6. Pas ankimit të ushtruar nga ana e prokurorisë, Gjykata e Apelit Gjyrokastër, pasi konstatoi vdekjen e shtetasit S.I., vendosi përfundimisht, me vendimin nr. 29, datë 19.2.2007, pushimin e çështjes penale në ngarkim të tij.

7. Më datë 28.7.2007, kërkuesi ka paraqitur në Gjykatën e Lartë kërkesë për rishikim në lidhje me vendimin nr. 445, datë 4.7.2002 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2009-303 (95), datë 19.3.2009 ka vendosur mospranimin e kërkesës për rishikim.

8. *Kërkuesi* i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (në vijim Gjykata), duke pretenduar se ndaj tij është zhvilluar një proces i parregullt ligjor. Më konkretisht, kërkuesi pretendon se:

8.1 Gjykata e Lartë i ka cenuar të drejtën e aksesit në gjykatë pasi nuk ka vlerësuar provat e paraqitura prej tij si “të reja”, për rishikimin e vendimit të formës së prerë;

8.2 Vendimi nr. 00-2009-303 (95), datë 19.3.2009 i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë është i paarsyetuar, për arsye se nuk është shprehur mbi njërin nga provat e paraqitura si “të reja”

8.3 Është cenuar parimi i paanësisë së gjykatës nga ana e Gjykatës së Apelit Gjjirokastër pasi njëri nga gjyqtarët e trupit gjykues ka marrë pjesë edhe në trupin gjykues në apel që ka gjykuar çështjen penale ndaj S.I.

9. *Subjekti i interesuar* ka pretenduar me shkrim dhe në seancë plenare se:

9.1 Kërkuesi ka pasur akses të plotë në Gjykatën e Lartë dhe ka marrë përgjigje përfundimtare në lidhje me kërkesën e tij për rishikim;

9.2 Kërkuesi ka parashtruar pretendime që lidhen me interpretimin dhe vlerësimin e rishikimit sipas nenit 494 të Kodit të Procedurës Civile (KPC), çka nuk përben objekt të kontrollit kushtetues;

9.3 Vendimi nr. 00-2009-303 (95), datë 19.3.2009 i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë është i arsyetuar dhe respekton standardet e arsytimit të përcaktuara nga jurisprudenca e Gjykatës;

9.4 Certifikata familjare nuk është provë e re, por përbën provë të administruar në shkallët e tjera, ku është shqyrtuar konflikti i themelit;

9.5 Gjyqtari i Gjykatës së Apelit Gjjirokastër, për të cilin kërkuesi ngre pretendimin për njëanshmëri, nuk ka marrë pjesë si anëtar i trupit gjykues të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

II

A. Për pretendimin e cenimit të së drejtës së aksesit në gjykatë, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës

10. Kërkuesi pretendon se i është mohuar e drejta e aksesit në gjykatë. Në mbështetje të këtij pretendimi, kërkuesi ka argumentuar se: a) akti i ekspertimit grafik nr. 1089, datë 25.3.2003, përbën provë të re të cilën ai nuk e dispononte gjatë zhvillimit të procesit civil; b) falsiteti i aktit të përdorur nga shtetasi S.I. është provuar në gjykimin penal; c) Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, duke referuar zgjidhjen e çështjes te pika “ç” e nenit 494 të KPC-së, nuk i ka dhënë zgjidhje asaj duke i mohuar të drejtën që çështja e tij të dëgjohet nga një gjykatë.

11. E drejta për t’iu drejtuar gjykatës (e drejta e aksesit) nënkupton të drejtën që ka çdo individ për të ngritur padi në një gjykatë që ka juridiksion të plotë për të zgjidhur çështjen (*shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 10, datë 11.5.2006*). Gjykata në jurisprudencën e saj është shprehur se e drejta për t’iu drejtuar gjykatës është një nga elementet e procesit të rregullt ligjor në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut (KEDNJ). E drejta për t’iu drejtuar gjykatave nuk përfshin vetëm të drejtën për të hapur proces, por edhe të drejtën për të pasur nga ana e gjykatës një zgjidhje përfundimtare në lidhje me mosmarrëveshjen. Aksesit në gjykatë duhet të jetë substantiv dhe jo formal. Mohimi i të drejtës për t’iu drejtuar Gjykatës dhe për të marrë një përgjigje përfundimtare prej saj lidhur me pretendimet e ngritura, përbën cenim të së drejtës themelore për një proces të rregullt ligjor (*shih vendimet nr. 14, datë 3.6.2009 dhe nr. 7, datë 11.3.2008 të Gjykatës Kushtetuese*).

12. Gjykata ka theksuar gjithashtu se e drejta për t’iu drejtuar një gjykate nuk është absolute. Kjo e drejtë mund të jetë pjesë e kufizimeve (veçanërisht lidhur me kushtet e pranimit të një apelimi), por këto kufizime nuk duhet të jenë të tilla sa të dëmtojnë vetë thelbin e së drejtës (*shih*



vendimet e Gjykatës Kushtetuese nr. 8, datë 16.3.2011; nr. 38, datë 30.12.2010; nr. 30, datë 17.6.2010).

13. Duke iu referuar jurisprudencës së GJEDNJ-së, Gjykata është shprehur se “në kuptim të nenit 6 § 1 të KEDNJ-së, mospranimi i një kërkesë në Gjykatën e Lartë nuk duhet të cenojë thelbin e së drejtës së ankimesit për t’iu drejtuar gjykatës (*shih vendimin nr. 5, datë 2.3.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

14. Në rastin konkret, kërkuesi i është drejtuar Gjykatës së Lartë me kërkesë për rishikimin e vendimit nr. 445, datë 4.7.2002 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, duke pretenduar se ka zbuluar prova të reja. Gjykata, në jurisprudencën e saj, ka pohuar se kërkesa për rishikim përfaqëson një formë të veçantë ankimi, një mjet të jashtëzakonshëm, me anë të të cilit kërkohet rishikimi i një vendimi të formës së prerë të gjykatës. Nëpërmjet këtij mjete ankimi mund të hapet një gjykim i mbyllur në mënyrë përfundimtare nga gjykata. Kërkesa për rishikim ushtrohet për shkaqe që qëndrojnë jashtë procesit të themelit, që do të thotë për fakte, prova, rrethana ose ngjarje për të cilat pala nuk kishte dijeni, nuk kishin ndodhur ose nuk ishin vërtetuar gjatë procesit gjyqësor dhe që kanë ndikuar në dhënien e vendimit në fjalë (*shih vendimin nr. 36, datë 26.7.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

15. Gjykata vëren se kërkesa për rishikim e paraqitur nga kërkuesi është marrë në shqyrtim nga Gjykata e Lartë, e cila ka analizuar pretendimet e kërkuesit dhe është shprehur mbi thelbin e tyre. Vetë kërkuesi ka pasur mundësi t’i parashtrojë pretendimet e tij gjatë seancës gjyqësore. Nisur nga këto verifikime të bëra në dosjen gjyqësore, Gjykata vlerëson se kërkuesi e ka realizuar të drejtën e aksesit në Gjykatën e Lartë, si nga pikëpamja formale, duke përdorur mjetin procedural ankimes të përshtatshëm (rishikimin) ashtu edhe në aspektin substancial, duke pasur parasysh se pretendimet e tij janë shqyrtuar në seancë nga Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, i cili i ka dhënë çështjes një përgjigje përfundimtare. Pretendimet e ngritura nga kërkuesi që kanë të bëjnë me vlerësimin e fakteve dhe rrethanave nuk përbëjnë objekt shqyrtimi kushtetues. Gjykata ka theksuar se “mënyra e vlerësimit të provave dhe në parim, mënyra e zbatimit të ligjit material është atribut i gjykatave të zakonshme (*shih vendimet: nr. 23, datë 17.5.2011 dhe nr. 106, datë 1.8.2001 të Gjykatës Kushtetuese*).

16. Për sa më sipër, Gjykata vlerëson se në rastin në shqyrtim, kërkuesit nuk i është cenuar e drejta e aksesit në Gjykatën e Lartë.

B. Për pretendimin e mosarsyetimit të vendimit gjyqësor

17. Kërkuesi ka pretenduar se vendimi i Gjykatës së Lartë për mospranimin e rishikimit, duke mos u shprehur mbi certifikatën familjare të paraqitur si provë të re, është i paarsyetuar.

18. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar domosdoshmërinë e arsyetimit të vendimit gjyqësor si një detyrim i sanksionuar në nenin 142 të Kushtetutës dhe një garanci për procesin e rregullt ligjor. Vendimi duhet të mbështetet vetëm mbi faktet që janë paraqitur gjatë procesit gjyqësor dhe duhet të përmbajë bazën ligjore mbi të cilën bazohet zgjidhja e mosmarrëveshjes, analizën e provave dhe mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes. Në tërësinë e tij ai duhet konsideruar si një unitet, në të cilin pjesët përbërëse janë të lidhura ngushtësisht mes tyre. Ato duhet të jenë në shërbim dhe në funksion të njëra-tjetrës (*shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese: nr. 12, datë 2.4.2008*).

19. Arsyetimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë. Vendimi mund të kontrollohet nga një gjykatë më e lartë sipas procedurave përkatëse dhe që kjo të jetë e mundur, duhet bërë arsyetimi i vendimit, në të cilin gjyqtari tregon me qartësi faktet dhe ligjin e zbatueshëm, të cilat e kanë çuar në gjetjen e një zgjedhjeje ndërmjet disa mundësive. Argumentet e dhëna në vendim duhet të jenë të mjaftueshme për të mbështetur dhe pranuar pjesën urdhëruese. Konkluzionet e pjesës arsyetuese duhet të bazohen jo vetëm në aktet ligjore, por edhe në parimet dhe rregullat që karakterizojnë mendimin e shëndoshë e logjik” (*shih vendimet: nr. 26, datë 13.6.2011; nr. 38, datë*

30.12.2010; nr. 23, datë 23.7.2009; nr. 7, datë 9.3.2009; nr. 11, datë 2.4.2008 të Gjykatës Kushtetuese).

20. Edhe GJEDNJ-ja, duke iu referuar procesit të drejtë të garantuar nga neni 6 i KEDNJ-së, ka theksuar se “Neni 6 i detyron gjykatat të arsyetojnë vendimet e tyre, por kjo nuk mund të kuptohet sikur kërkohet një përgjigje e detajuar për çdo argument. Detyrimi për të arsyetuar vendimin, varet nga natyra e vendimit në fjalë” (*shih vendimet e GJEDNJ-së në çështjen Marini kundër Shqipërisë, datë 18 dhjetor 2007, § 105; dhe në çështjen Van de Hurk kundër Holandës, 19 prill 1994, § 61*).

21. Në rastin konkret, Gjykata vëren se vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë përmban, në pjesën arsyetuese, bazën ligjore mbi të cilën bazohet zgjidhja e çështjes, vlerësimin e provave të cilat kërkuesi i ka paraqitur si prova të reja, dhe mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes. Nga analiza e dosjes gjyqësore rezultojnë se certifikata familjare nr. prot. 7/1, datë 7.5.2001, e cila është paraqitur nga kërkuesi si provë e re, është administruar dhe vlerësuar në gjykimet e mëparshme, më konkretisht gjatë shqyrtimit gjyqësor në Gjykatën e Shkallës së Parë të Rrethit Sarandë (*shih vendimin nr. 455, datë 4.7.2003, fq. 4*). Gjykata e Lartë në vendim shprehet se “nuk rezultojnë të ndodhemi para ndonjërit nga rastet e parashikuara në nenin 494 të Kodit të Procedurës Civile e për rrjedhojë nuk ka vend të rishikohet vendimi”. Nisur nga fakti se kërkuesi ka kërkuar rishikimin e vendimit gjyqësor pikërisht në bazë të nenit 494/a (prova të reja), arsyetimi i mësipërm i Gjykatës së Lartë nënkupton se nuk jemi përpara ndonjë prove apo rrethane të re, që nuk dihej nga pala dhe për të cilën mund të kërkohet rishikimi i vendimit. Në vlerësimin e Gjykatës, nuk rezultojnë që vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë të jetë jologjik, të ketë kundërthënie, të mos ketë referencë në ligjin e zbatueshëm dhe të mos respektojë standardet e arsyetimit të vendimit të përmendura më sipër. Për rrjedhojë, Gjykata çmon se vendimi i Gjykatës së Lartë, objekt shqyrtimi, nuk cenon kërkesat që lidhen me arsyetimin e vendimit gjyqësor, në kuptimin kushtetues, prandaj dhe ky pretendim i kërkuesit është haptazi i pambështetur.

C. Për pretendimin e cenimit të parimit të paanshmërisë së gjykatës

22. Kërkuesi pretendon se është cenuar parimi i paanshmërisë së gjykatës, për arsye se gjyqtari T.S. ka qenë pjesëtar i trupit gjykues në apel si në çështjen civile, të iniciuar nga kërkuesi ashtu dhe në çështjen penale ndaj shtetasit S.I.

23. Gjykimi nga një gjykatë e paanshme është një nga elementet e rëndësishme të procesit të rregullt ligjor, sanksionuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së. Gjykata ka theksuar, në jurisprudencën e saj, se parimi i paanshmërisë ka në vetvete elementin e vet *subjektiv*, i cili lidhet ngushtë me bindjen e brendshme që krijon gjyqtari për zgjidhjen e çështjes në gjykim, si dhe elementin *objektiv* me të cilin kuptohet dhënia e garancive të nevojshme për gjykim të paanshëm nga vetë gjykata, përmes mënjanimi prej saj të çdo dyshimi të përligjur në këtë drejtim (*shih vendimet: nr. 33, datë 22.7.2011; nr. 21, datë 29.4.2010; nr. 12, datë 13.4.2007 të Gjykatës Kushtetuese*).

24. Nga aktet e dosjes gjyqësore, në çështjen konkrete, rezultojnë se gjyqtari T.S. ka marrë pjesë në trupin gjykues të Gjykatës së Apelit Gjirokastrës, në çështjen civile me paditës kërkuesin dhe më pas ka qenë pjesëtar, si kryesues, i trupit gjykues të Gjykatës së Apelit Gjirokastrë në çështjen penale ndaj shtetasit S.I.

25. Në lidhje me këtë pretendim të kërkuesit, Gjykata evidenton se objekti i këtij shqyrtimi kushtetues është vendimi i rishikimit të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, i cili kërkohet të shpallet si i papajtueshëm me Kushtetutën. Kërkesa për rishikim përfaqëson një formë të veçantë ankimi, një mjet të jashtëzakonshëm, i cili ushtrohet për shkaqe që qëndrojnë jashtë procesit të themelit. Një kërkesë për rishikimin e një vendimi gjyqësor të formës së prerë mund të paraqitet vetëm në rastet e parashikuara në mënyrë taksative nga neni 494 i KPC-së. Gjykata çmon se në rastin konkret, pretendimi i cenimit të paanshmërisë subjektive të gjykatës i përket procesit penal ndaj shtetasit S.I. dhe nuk ka lidhje me vendimin e rishikimit që kërkohet të shfuqizohet nga Gjykata. Gjyqtari T.S. nuk ka marrë pjesë në përbërje të trupit gjykues në Gjykatën e Lartë kur kjo e fundit ka shqyrtuar



kërkesën për rishikim. Për pasojë, Gjykata vlerëson se nuk jemi përpara rastit të cenimit të parimit të paanshmërisë së gjykatës, ndaj ky pretendim i kërkuesit është haptazi i pabazuar.

26. Si përfundim, bazuar në çka më sipër, Gjykata çmon se nuk ndodhet përpara cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, në vështrim të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 131 shkronja “f” dhe nenit 134 pika 1 shkronja “g” të Kushtetutës, si dhe të nenit 72 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, njëzëri,

VENDOSI:

- Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Bashkim Dedja (kryetar), Xhezair Zaganjori, Vladimir Kristo, Sokol Berberi, Vitore Tusha, Petrit Pllloçi, Fatmir Hoxha, Altina Xhoxhaj, Admir Thanza

VENDIM Nr.21, datë 16.4.2012

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	Kryetar	i	Gjykatës	Kushtetuese
Vladimir Kristo	Anëtar	i	“	“
Xhezair Zaganjori	Anëtar	i	“	“
Vitore Tusha	Anëtare	e	“	“
Sokol Berberi	Anëtar	i	“	“
Fatmir Hoxha	Anëtar	i	“	“
Admir Thanza	Anëtar	i	“	“
Altina Xhoxhaj	Anëtare	e	“	“
Petrit Pllloçi	Anëtar	i	“	“

me sekretare Elta Milori, në datë 20.12.2011, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të mbyllura çështjen nr. 50/25 Akti, që i përket:

KËRKUES: Shpëtim Bajrami, i përfaqësuar nga avokat Ardian Leka, me prokurë.

SUBJEKTI I INTERESUAR: Prokuroria e Përgjithshme, në mungesë.

OBJEKTI: Shfuqizimin, si të papajtueshëm me Kushtetutën, të vendimit nr.64, datë 1.10.2006 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Librazhd; të vendimit nr. 267, datë 19.6.2007 të Gjykatës së Apelit Durrës, dhe vendimit nr. 211 datë 9.4.2009 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë (Dhoma e Këshillimit).

BAZA LIGJORE: Nenet 42/2, 32/2, 131/f e 134/g të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

GJYKATA KUSHTETUESE

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Petrit Pllloçi, mbrojtësin e kërkuetit avokatin Ardian Leka, i cili kërkoi shfuqizimin si jokushtetuese të tri vendimeve të mësipërme dhe dërgimin e çështjes për rigjykim, dhe pasi shqyrtoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Librazhd, me vendimin nr.64 datë 1.10.2006, ka vendosur deklarimin fajtor të kërkuetit për veprat penale të vrasjes me dashje kundër dy personave, e kryer në bashkëpunim dhe armëmbajtjes pa leje dhe vënies në përdorim të një pasaporte të falsifikuar, vepra penale të parashikuara nga nenet 79/dh e 25, 278/2 e 189/1 të Kodit Penal, duke e dënuar përfundimisht kërkuetin me 25 vjet burgim e 400.000 lekë gjobë. Gjykata e Apelit Durrës, me vendimin nr. 267 datë 19.6.2007 ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 64 datë 1.10.2006 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Librazhd, ndërsa Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, në Dhomën e Këshillimit, me vendimin nr. 211 datë 9.4.2009, ka vendosur mospranimin e rekursit të ushtruar nga prokurori dhe kërkueti.

Kërkueti pretendon cenim të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, për shkak se:

- është cenuar parimi i paanshmërisë së gjykatës, sepse në kundërshtim me nenin 15/1§2 të Kodit të Procedurës Penale, i njëjti gjyqtar ka vlerësuar masën e sigurimit, sigurimin e provës dhe kërkesën për përjashtimin e trupit gjykues të gjykimit të themelit të akuzës;

- në marrjen e dëshmisë prej një pjese të dëshmitarëve, në kundërshtim me nenin 360 të Kodit të Procedurës Penale, nuk është lexuar përmbajtja e kësaj dispozite, por është mjaftuar vetëm me fjalët se përmbajtja e saj iu është bërë e njohur dhe fjala “betohem” është shprehur prej tyre;

- vendimi për rrëzimin e kërkesës për gjykim të shkurtuar ka cenuar të drejtën e kërkuetit për të përfituar uljen e dënimit, sipas urdhërimit të nenit 406§1 të Kodit të Procedurës Penale;

- vendimi për rrëzimin e kërkesës për gjykim të shkurtuar është i paarsyetuar, duke mos përmbushur detyrimin e sanksionuar në nenin 142/1 të Kushtetutës dhe nenin 112/1§3 të Kodit të Procedurës Penale që vendimet gjyqësore të jenë të arsyetuara;

- Kolegji i Gjykatës së Lartë, në Dhomë Këshillimi, në kundërshtim me nenin 432 të Kodit të Procedurës Penale dhe me vendimin nr. 10 datë 2.4.2009 të Gjykatës Kushtetuese, ka vendosur mospranimin e rekursit, edhe pse pretendimet mbi shkeljet e parimeve themelore të procesit të rregullt ligjor ishin ngritur në recurs dhe gjenin pasqyrim në materialet e çështjes. Sipas kërkuetit, ky vendim i Kolegjit të Gjykatës së Lartë, duke mos verifikuar shkaqet e rekursit dhe duke mos arsyetuar shkaqet e mospranimit të tij, vjen në kundërshtim me nenin 112/1§3 të Kodit të Procedurës Penale.

II

I. Mbi pretendimin për cenimin e së drejtës për t’iu drejtuar gjykatës (e drejta e aksesit)

Kërkueti ka parashtruar se Gjykata e Apelit nuk ka shqyrtuar pretendimin e tij të ngritur në apelim për padrejtësinë e vendimit të gjykatës së shkallës së parë për refuzimin e kërkesës për gjykim të shkurtuar. Sipas tij, edhe pse ekzistonin kushtet e nenit 406/1 të Kodit të Procedurës Penale, gjykata nuk zhvilloi një gjykim të shkurtuar, me pasojën e mosuljes së dënimit në një të tretën, siç parashikon kjo dispozitë.

Gjykata Kushtetuese vlerëson se ky pretendim, në thelb, ka të bëjë me themelsinë e vendimit për rrëzimin e kërkesës për gjykim të shkurtuar nga gjykata e shkallës së parë, si dhe mohimin nga ana e Gjykatës së Apelit Durrës të të drejtës së apelimit dhe të aksesit në këtë gjykatë për të kontrolluar vendimin e gjykatës së shkallës së parë për refuzimin e gjykimit të shkurtuar.

Duke pasur parasysh arsyetimin e mësipërm të Gjykatës së Apelit, Gjykata Kushtetuese konstaton se shkak për të cilin kjo gjykatë ka vendosur ta konsiderojë të pabazuar pretendimin e



ngritur në ankim nga kërkuesi mbi padrejtësinë e vendimit për rrëzimin e kërkesës për gjykim të shkurtuar, ka qenë vlerësimi i saj se disponimi në lidhje me pranimin ose jo të kërkesës për gjykim të shkurtuar, është atribut i gjykatës së shkallës së parë. Në këtë drejtim, Gjykata Kushtetuese vlerëson se një qëndrim i tillë i Gjykatës së Apelit bën që vendimet e gjykatës së shkallës së parë, lidhur me mospranimin e kërkesës për gjykim të shkurtuar, të mos kontrollohen mbi bazë apelimi në shkallë të dytë. Për pasojë, Gjykata Kushtetuese duhet të shqyrtojë nëse lënia jashtë kontrollit juridiksional e vendimit të gjykatës së shkallës së parë që refuzon gjykimin e shkurtuar, shkel të drejtën e aksesit të kërkuesit për një gjykim në shkallë të dytë. Për t'i dhënë përgjigje kësaj pyetjeje, duhet të shqyrtohet se çfarë të drejtash gëzon i gjykuari për të kundërshtuar vendimin e gjykatës së shkallës së parë kur nuk është dakord me këtë vendim.

Në këtë drejtim, Gjykata Kushtetuese vëren se, sipas neneve 407/3 dhe 422 të Kodit të Procedurës Penale, i pandehuri gëzon të drejtën e apelit të vendimeve të gjykatës së shkallës së parë. Kjo e drejtë apelimi shtrihet si ndaj fajësisë ashtu edhe ndaj masës së dënimit të dhënë nga kjo gjykatë. Kjo do të thotë se, lidhur me dënimin, i gjykuari mund të apelojë masën e dënimit të dhënë nga pikëpamja e respektimit të parimit të proporcionalitetit. Ky parim shkelet edhe në rast se plotësohen kriteret për një gjykim të shkurtuar, me pasojën e uljes në një të tretën e dënimit (nenet 404 e 406/1 të Kodit të Procedurës Penale). Kjo, për arsye se realizimi i funksionit riedukues të dënimit kërkon që gjykata, në përcaktimin e këtij dënimi, të respektojë parimin e proporcionalitetit. Për rrjedhojë, në rast se në shkallë të parë është vazhduar me procedurën e gjykimin të zakonshëm, vendimi i gjykatës mund të apelohej për dhënien e një dënimi të paligjshëm, duke arsyetuar se refuzimi i gjykimin të shkurtuar është i pajustificuar ose i gabuar. Në këtë rast, i pandehuri kërkon që gjykata e apelit të kontrollojë arsyetimet ku mbështetet vendimi i mospranimin të gjykimin të shkurtuar, duke e kundërshtuar këtë vendim për arsye se ka vënë në dyshim ligjshmërinë e dënimit të dhënë. Për pasojë, përcaktimi konkret i dënimit është i rivlerësueshëm nga gjykata e apelit, dhe nëse kjo gjykatë vlerëson se është i pajustificueshëm refuzimi i gjykimin të shkurtuar, duhet të aplikojë dënim të reduktuar, edhe pse procedura e ndjekur nuk ka qenë ajo e gjykimin të shkurtuar. Pra, motivet e vendimit që refuzon gjykimin e shkurtuar, të cilat influencojnë mbi ligjshmërinë e dënimit që do të jepet, nuk mund të përjashtohen nga shqyrtimi thelbësor nga gjykata e apelit mbi ankim. E gjithë kjo, jo me qëllim të rikuperimit të rritit të posaçëm, por të apelit, në rast dënimi, të dënimit të reduktuar (*shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.14, datë 26.3.2012, par.23 e 24*).

Në rastin në shqyrtim, Gjykata Kushtetuese vëren se, referuar vendimit nr. 267 datë 19.6.2007 të Gjykatës së Apelit Durrës, kjo gjykatë ka arsyetuar se: “*disponimi në lidhje me pranimin ose jo të gjykimin të shkurtuar është atribut i gjykatës së shkallës së parë,*” dhe se “*edhe në vendimin unifikues të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë nr. 2, datë 29.1.2003, është unifikuar praktika gjyqësore për faktin se Gjykata e Apelit duhet t'i përmbahet llojit të gjykimin të ndjekur nga gjykata e shkallës së parë*”. Duke pasur parasysh këtë arsyetim të Gjykatës së Apelit, Gjykata Kushtetuese konstaton se shkaku për të cilin kjo gjykatë ka vendosur ta konsiderojë të pabazuar pretendimin e ngritur në ankim nga kërkuesi mbi padrejtësinë e vendimit për rrëzimin e kërkesës për gjykim të shkurtuar, ka qenë vlerësimi i saj se disponimi në lidhje me pranimin ose jo të kërkesës për gjykim të shkurtuar, është atribut i gjykatës së shkallës së parë. Kjo do të thotë se, sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit Durrës, vendimi i gjykatës së shkallës së parë, lidhur me refuzimin e kërkesës për gjykim të shkurtuar, të mos i nënshtrohet kontrollit juridiksional në shkallë të dytë.

Në opinionin e Gjykatës Kushtetuese, kjo do të thotë që mungesa e kontrollit në shkallë të dytë të këtij vendimi refuzimi mbron aksesin për një gjykim në shkallë të dytë, lidhur me pretendimet për mosrespektimin e parimit të proporcionalitetit në caktimin e dënimit. Për pasojë, Gjykata Kushtetuese konkludon se, në vetvete, ky qëndrim i gjykatës së apelit, i ka cenuar kërkuesit të drejtën kushtetuese të aksesit dhe të ankimit në një gjykatë më të lartë.

2. Mbi pretendimet për “cenimin e parimit të paanësisë në gjykim”, “cenimin e së drejtës për të mos u deklaruar fajtor mbi bazën e të dhënave të mbledhura në mënyrë të paligjshme”, si dhe për “mopërbushjen e detyrimit të arsytimit të vendimit gjyqësor” (nenet 32/2, 42 e 142/1 të Kushtetutës)

Kërkuesi ka pretenduar se në gjykimin ndaj tij është shkelur parimi i paanësisë në gjykim (neni 42/2 i Kushtetutës), e drejta për të mos u deklaruar fajtor mbi bazën e të dhënave të mbledhura në mënyrë të paligjshme (nenet 32/2 dhe 42 të Kushtetutës), si dhe nuk është përmbushur detyrimi kushtetues që vendimet gjyqësore të jenë të arsytuara (nenet 42 e 142/2 të Kushtetutës).

Gjykata Kushtetuese, referuar dosjes gjyqësore të gjykimit të zakonshëm, konstaton se këto pretendime nuk janë ngritur në ankimin në gjykatën e apelit dhe rekursin në Gjykatën e Lartë. Në këtë këndvështrim, Gjykata Kushtetuese rithekson se rregulli i shterimit të mjeteve, sanksionuar nga neni 131, shkronja “f” e Kushtetutës, nënkupton jo vetëm që ankuesi t’u jetë drejtuar të gjitha instancave gjyqësore të zakonshme përpara se t’i drejtohet Gjykatës Kushtetuese, por edhe që të gjitha pretendimet, që ka për qëllim t’i ngrejë në këtë Gjykatë, duhet t’i ketë paraqitur më parë në të gjitha instancat e zakonshme gjyqësore, të paktën në substancë, si dhe duke respektuar kërkesat formale dhe afatet e parashikuara në ligjin procedural. Për pasojë, Gjykata Kushtetuese vlerëson se kërkuesi, duke mos respektuar standardin kushtetues të shterimit të mjeteve juridike përpara paraqitjes së kërkesës në këtë gjykatë, nuk mund të vërë në lëvizje gjykimin kushtetues.

Për sa më sipër, këto pretendime nuk mund të merren në shqyrtim nga Gjykata Kushtetuese.

3. Mbi pretendimin e cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor nga Gjykata e Lartë si pasojë e mospranimin të rekursit në Dhomën e Këshillimit

Kërkuesi ka pretenduar gjithashtu se Kolegji i Gjykatës së Lartë, në Dhomë Këshillimi, ka vendosur mospranimin e rekursit, edhe pse pretendimet mbi shkeljet e parimeve themelore të procesit të rregullt ligjor ishin ngritur në rekurs dhe gjenin pasqyrim në materialet e çështjes. Sipas kërkuesit, ky vendim i Kolegjit të Gjykatës së Lartë, duke mos verifikuar shkaqet e rekursit dhe duke mos arsytuar shkaqet e mospranimin të tij, vjen në kundërshtim me nenin 112/1§3 të Kodit të Procedurës Penale.

Gjykata Kushtetuese rithekson se, bazuar në nenin 433 të Kodit të Procedurës Penale, është kompetencë e Kolegjit Penal në Dhomën e Këshillimit të analizojë dhe të vlerësojë nëse shkaqet e ngritura në rekurs janë në përputhje me kërkesat e ligjit. Në rast se Kolegji, në Dhomën e Këshillimit, krijon bindjen se shkaqet e ngritura në rekurs objektivisht nuk ekzistojnë në dosjen gjyqësore, atëherë është në funksionin e tij të vendosë, në pajtim me kërkesat ligjore, mospranimin e çështjes për shqyrtim në seancë gjyqësore (*vendimi i Gjykatës Kushtetuese nr.10, datë 2.4.2009*). Nga pikëpamja kushtetuese, vetëm kur janë të pranishme pretendime që kanë të bëjnë me shkeljen e parimeve themelore të procesit gjyqësor, si dhe kur këto pretendime gjejnë pasqyrim në materialet e çështjes, atëherë vendimi i Kolegjit për mospranimin e rekursit, vë në dyshim të drejtën për një proces të rregullt ligjor (*vendimi i Gjykatës Kushtetuese nr.19, datë 19.7.2005*).

Në rastin në shqyrtim, Gjykata Kushtetuese, duke iu përmbajtur qëndrimit të parashtuar më sipër, se gjykata e apelit i ka cenuar kërkuesit të drejtën e aksesit në këtë gjykatë (aksesin në gjykatën e apelit), çmon se Gjykata e Lartë duhet të investohej në ekzaminimin e këtyre pretendimeve dhe të mbante një qëndrim të shprehur lidhur me to. Kjo, për arsye se kontrolli i respektimit të standardeve kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, është funksion edhe i gjykatave të zakonshme, e aq më tepër i Gjykatës së Lartë. Një linjë e tillë, lidhur me raportin ndërmjet juridiksionit kushtetues dhe juridiksionit të gjykatave të zakonshme, kur është rasti i shqyrtimit nga ana e Gjykatës Kushtetuese të kërkesave individuale, në bazë të nenit 131/f të Kushtetutës, udhëhiqet nga parimi i subsidiaritetit (komplementaritetit). Një qëndrim i ndryshëm do ta kthente Gjykatën Kushtetuese në një instancë të zakonshme, gjë që nuk është funksioni i saj (*vendimi nr. 4, datë 28.2.2006 i Gjykatës Kushtetuese*).



Për sa më sipër, Gjykata Kushtetuese vlerëson se vendimi i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë është rezultat i një procesi të parregullt ligjor dhe si i tillë duhet të deklarohet antikushtetues.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 72 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,

VENDOSI:

- Shfuqizimin, si të papajtueshëm me Kushtetutën, të vendimit nr. 211 datë 9.4.2009 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.
- Dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Kolegjin Penal të Gjykatës së Lartë.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë pro: Bashkim Dedja (kryetar), Fatmir Hoxha, Vladimir Kristo, Vitore Tusha, Admir Thanza

Anëtarë kundër: Xhezair Zaganjori, Petrit Plloçi, Sokol Berberi, Altina Xhoxhaj

MENDIM PARALEL

1. Gjykata Kushtetuese (Gjykata) ka pranuar pretendimet e kërkuesit, duke shfuqizuar si të papajtueshëm me Kushtetutën vendimin nr. 211, datë 9.4.2009 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë dhe dërgimin e çështjes për rigjykim në po atë gjykatë, me arsyetimin se gjykata e apelit, duke mos pranuar ankimin e ngritur nga kërkuesi mbi padrejtësinë e vendimit të rrëzimit të kërkesës për gjykim të shkurtuar të shkallës së parë, i ka cenuar kërkuesit të drejtën e aksesit në gjykatë. Për pasojë, Gjykata e Lartë duhej të investohej në ekzaminimin e këtyre pretendimeve të ngritura në rekurs dhe të mbante një qëndrim të shprehur lidhur me to.

2. Pavarësisht se në qëndrimin përfundimtar pajtohem me vendimin e shumicës për pranimin e kërkesës, argumentet e shumicës për shfuqizimin e vendimit të Gjykatës së Lartë me arsyet e mësipërme, më duken të sforcuara dhe duke qenë se çështjen në fjalë e shoh nga një këndvështrim tjetër, më poshtë po jap arsyet e këtij mendimi paralel.

3. Duke u nisur nga veçoritë dhe kufijtë e shqyrtimit të çështjes në gjykatën e apelit, të përcaktuara në nenin 425 të KPP-së, ritheksoj mendimin e shprehur edhe më parë se fakti që gjykata e apelit ka konsideruar si të pabazuar pretendimin e kërkuesit mbi padrejtësinë e vendimit të mospranimit të gjykimit të shkurtuar, nuk i ka cenuar kërkuesit të drejtën e aksesit në gjykatë, në kuptimin kushtetues. Ky i fundit, jo vetëm ka realizuar të drejtën për t’iu drejtuar gjykatës, por edhe të drejtën për të pasur një zgjidhje përfundimtare, përdërisa ankimi i tij është shqyrtuar dhe konsideruar jo vetëm nga gjykata e apelit por edhe nga Gjykata e Lartë (*shih më gjerë mendimin e pakicës në vendimin nr. 14, datë 26.3.2012 të Gjykatës Kushtetuese*).

4. Lidhur me pretendimin e cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor nga ana e Gjykatës së Lartë, si pasojë e mospranimit të rekursit në Dhomën e Këshillimit, Gjykata, në jurisprudencën e saj, ka theksuar se kontrolli i respektimit të standardeve kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, është funksion edhe i gjykatave të zakonshme, e aq më tepër i Gjykatës së Lartë. Kur në rekurs janë ngritur pretendime të cilat janë të rëndësishme për verifikimin e

kushtetutshmërisë së procesit të zhvilluar në gjykatat e zakonshme, Gjykata e Lartë, bazuar në natyrën e gjykimit kushtetues të kërkesave individuale, si dhe në parimin e subsidiaritetit që udhëheq raportet ndërmjet juridiksionit kushtetues dhe juridiksionit të gjykatave të zakonshme, duhet të investohet në ekzaminimin e tyre dhe të mbajë një qëndrim të shprehur lidhur me to. Një qëndrim i ndryshëm do ta kthente Gjykatën Kushtetuese në një instancë të zakonshme, gjë që nuk është funksioni i saj (*shih vendimet nr.19, datë 2.4.2012 ; nr.4, datë 28.2.2006 dhe nr.41, datë 29.12.2005 të Gjykatës Kushtetuese*).

5. Sikurse edhe shumica, mendoj se Gjykata e Lartë duhej të investohej në ekzaminimin e pretendimeve të ngritura në rekurs nga kërkuesi, por jo për faktin, sikurse argumenton shumica, se gjykata e apelit i ka cenuar kërkuetit të drejtën e aksesit në këtë gjykatë (të apelit), por sepse duke qenë se pretendimet e kërkuetit kishin të bënin me shkeljen e parimeve themelore të procesit gjyqësor, pra kishin natyrë ligjore, kjo gjykatë, në funksion të rolit të saj në kontrollin dhe respektimin e standardeve kushtetuese nga gjykatat më të ulëta, duhet t'i jepte përgjigje këtyre pretendimeve. Në këtë këndvështrim, jam i mendimit se vendimi i Gjykatës së Lartë i ka cenuar kërkuetit të drejtën për një proces të rregullt ligjor.

Anëtar: Vladimir Kristo

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-ekspozitës “Shqipëria Sot”, tel: 04 24 27 007.
Çmimi i abonimit pranë Postës Shqiptare, për Fletoret Zyrtare 2012, është 16 000 lekë.
Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

Hyri në shtyp më 27.4.2012
Doli nga shtypi më 29.4.2012

	Formati: 61x86/8
--	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2012

Çmimi 44 lekë